



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” në:
“Arsim Parashkollor”
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr.Gëzim Dibra

Prof.Assoc.Dr Robert Gjedia

Shkurt/ 2024

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimn. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Tabela Pëmbledhëse për programin e studimit Bachelor në “Arsimin Parashkollor”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Pedagogjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Arsim Parashkollor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 371, date 05.09.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim senati Nr 61, date 14.06.2018 Miratuar MASR shkr.Nr 7238/1, dt 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 286, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020-2021 11 PAE 4 PAK 2021-2022 10 PAE 5 PAK 2022-2023 11 PAE 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 -45 studentë. 2021-2022 -35 studentë 2020-2021 - 28 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua duke u mbështetur në dy elemente kryesorë, si: Shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit të Durrësit “Aleksandër Moisiu” (në vijim UAMD) dhe së dyti sipas veprimtarive të realizuara konform agjendës së miratuar nga dy institucionet ASCAL dhe UAMD. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet e evidentuara nga analiza e procesit të vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë me emërtesë Bachelor në Arsimin Parashkollor. Programi i studimit është hapur me Urdhër të MASH Nr. 371, datë 05.09.2013 (*Vendimi i KA propozon licencimin e këtij programi si program i ciklit të parë*). *Urdhri përkatës e ka licensuar si program i ciklit të parë “ Bachelor”.*

Programi ofrohet prej Departamenti i Pedagogjisë të Fakultetit të Edukimit (FE) në UAMD.

Aktualisht, programi Bachelor në Arsim Parashkollor është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program synon të formojë mësues për arsimin parashkollor. Ai përmban gjithsej 180 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 3 vite akademike / 6 semestra. Në përfundim të ciklit të studimit tre vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare Diplomë “Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. *Forma e regjistrimit të diplomës: Urdhër QSHA Nr. 286, datë 22.10.2020.*

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program në tre vitet e fundit, është:

- Për vitin akademik 2022-2023 është 45 studentë
- Për vitin akademik 2021-2022 është 35 studentë
- Për vitin akademik 2020-2021 është 28 studentë

Gjithsej 108 studentë. Të diplomuar 26 studentë në vitin akademik 2022-2023

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor nuk ka kaluar më parë proces akreditimi. Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, nga ana e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Arsimin Parashkollor. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga Prof.Dr. Gëzim Dibra dhe Prof.Asoc.Dr. Robert Gjedia dhe gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, znj. Anilda Beqiraj. Vizitat u realizuan në datat 11 dhe 12 Tetor 2023. Për përmbushjen me sukses të këtij vlerësimi të jashtëm, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije nga ekspertja e ASACL.

Dokumentacioni ligjor mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Arsim Parashkollor në FE, të UAMD-së, është:

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 801 datë 20.12.2005 “Për Vendimin e hapjes së Universitetit të Durrësit “Aleksandër Moisiu”
- Urdhër MASH Nr. 371, datë 05.09.2013, i bazuar në *Vendimin e KA, propozon licencimin e Programit Bachelor në “Arsim Parashkollor” si program i ciklit të parë i studimeve bachelor në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.*
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
- VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018”.
- Statutin e UE dhe Rregulloret në UAMD.
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

Aktivitetet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete duke përfshirë analizën e të dhënave parësore dhe dytësore si dhe vizitat në ambientet e brendshme të UAMD dhe FE-së.

Analiza e të dhënave parësore është bazuar nga të dhënat e marra nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe evidencat përkatëse për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në Arsim Parashkollor (Pril 2023), i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit.

Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Drejtues të institucionit që mbulojnë programin e studimit;
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program;
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë dhe të Çështjeve Mësimore.

- Takim me studentë të këtij programi;
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve
- Vizitë në Sekretarinë mësimore;
- Takim me Përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore;
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe i bibliotekës
- Takim me Drejtues te institucionit që mbulojne programin e studimit;

Qëllimi i këtyre takimeve ishte realizmi i bisedave që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. Pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, ishte edhe:

Vëzhgimi i mjediseve mësimore në dispozicion të programit të studimit nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm, si: auditorë, laboratorë të arteve, të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve të bibliotekës së FE-së dhe të UAMD-së. Mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB si dhe nga evidencat përkatëse, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.

Universiteti A. Moisiu, është njohur me DRVJ më datë 29.01.2024, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 19/18 prot date 30.01.2024. Universiteti dërgon komente me shkresë zyrtare 328 datë 14.02.2024 .Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Arsimin Parashkollor”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga UAMD evidentohet se Programi i Studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor” është në përputhje dhe përshtatje me interesat kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe me qëllimet kombëtare. Programi i studimit synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në funksion të komunitetit, shtetit, etj, duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve në nivel lokal, rajonal e më gjerë, mbështetur në “Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ¹ dhe udhëzimet e ardhura nga MAS. Ky program studimi synon të ruajë vlerat kulturore kombëtare ² dhe përpiqet të pasurojë dhe të rrisë këto vlera si dhe synimet akademike të studentit nëpërmjet aktiviteteve që i promovojnë ato.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Konstatohet se, nga shqyrtimi i Statutit të institucionit si dhe i planit Strategjik të FE-së, Programi i studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor” është në përputhje me qëllimet strategjike të dhe me misionin e institucionit, sepse ky program studimi synon një edukim cilësor dhe të përshtatshëm të brezit të ri, si dhe ka për detyrë të krijojë aftësi bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike, sipas fushave që mbulon ³ Po ashtu konstatohet se programi i studimit është hartuar në harmoni me Statutin dhe objektivat e UAMD-së, si dhe janë bazuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të UAMD (2020-2025) ⁴ . Vihet re se Programi i studimit “Bachelor” në “Arsimin Parashkollor” ka për qëllim arritjen prej studentëve të kompetencave thelbësore, praktike funksionale, si edhe komunikuese me synim kryesor pajisjen e studentit me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit, me aftësim drejt një profesioni ⁵ . Konstatohet se në Rregulloren e Programit të Studimit, në

¹Evidencë 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës

²Evidencë Nr 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës <https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf>.

³Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2020 - 2025). <https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/02/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf>

⁴Evidenca Nr. 2 - Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2020 - 2025). <https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/02/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf>

⁵Evidenca Nr. 3.1.1.2 - Rregullore e programit të studimit Bachelor “Arsim Parashkollor” 2019.

	Rregulloren për Praktikën Profesionale ⁶ , evidentohet se ky program studimi është hartuar në harmoni me misionin dhe objektivat e UAMD-ja, të përshkruara qartë në Statutin e UAMD-së ⁷ dhe Planin Strategjik të Zhvillimit (2020-2025) ⁸ .
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Konstatohet se Programi i studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor” është në përputhje me qëllimet strategjike 2019-2022 dhe 2022-2026 të UAMD dhe statutit të saj. Evidentohet se Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UAMD dhe ky program studimi përgatit specialistë në fushën e arsimit parashkollor, duke kontribuar në përgatitjen teoriko-praktike përmes lëndëve të përgjithshme dhe specifike, praktikave pasive e aktive në kopshte të këtyre mësuesve të ardhshëm.
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita dhe takimet në IAL evidentohet se Programi i studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor” ofrohet nga departamenti i Pedagogjisë, i cili është njësi bazë në Fakultetin e Edukimit. Ky departament ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e tij. Departamenti i Pedagogjisë ka 13 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 1 ka titullin “Profesor”, 7 kanë titullin “Profesor i Asociuar” si edhe 5 kanë gradën “Doktor Shkencash” ⁹ . Në këtë program sipas nevojave përfshihen edhe pedagog të jashtëm. Konstatohet se Departamenti i Pedagogjisë përmbushkriteret sasiore dhe cilësore të stafit akademik, kualifikimet e duhura për zbatimin e efektshëm të programit. Vihet re qartë se stafi akademik me kohë të plotë dhe stafi akademik me kohë të pjesshme ka përgatitje të përshtatshme akademike e shkencore, në përputhje me kërkesat e këtij programi studimi, si dhe ruhet dhe respektohet raporti i stafit akademik me kohë të plotë dhe stafi akademik me kohë të pjesshme.
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për	Rezulton se Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit ¹⁰ , me strategjinë e zhvillimit të njësisë bazë ¹¹ . Fushat e studimit të këtij programi bazohet në drejtimet e kërkimit shkencor të UAMD. Rregullorja mësimore e programit të studimit “Bachelor” në “Arsim Parashkollor” e ofruar nga Departamenti i Pedagogjisë, mbështetet në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, në VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e

⁶Evidenca Nr. 102 - Rregullore e praktikës profesionale.

⁷Evidenca Nr. 1 - Statuti i UAMD. <https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf>

⁸Evidenca Nr.2 - Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2020 - 2025).

⁹ UAMD, FE, DP, Evidencë 64.1 Stafit akademik për programin e studimit Bachelor “Arsim Parashkollor” 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023

¹⁰Evidenca 2 - Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025

¹¹Evidenca 9 - Strategjia e Departamentit të Pedagogjisë 2022-2025

programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, si edhe në Udhëzimin e MASR nr.31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”.			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit I.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi është në përputhje me qëllimet dhe interesat kombëtare. Ky program ka 10 vite që zbatohet nga UAMD dhe kjo IAL ka kapacitete të kualifikura dhe të mjaftueshme për zhvillimin e efektshëm të tij, ndaj GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion konstatojmë se Departamenti i Pedagogjisë lidhur me zbatimin e programit e programit mësimor në Bachelor në “Arsim Parashkollor” ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi brenda fakultetit me departamente të tjera për të mundësuar realizimin efektiv të kompetencave që ka ky program studimi. Realizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit ka qenë i nevojshëm për mbulimin e lëndëve që përbëjnë kurrikulën e këtij programi studimi dhe që zhvillohen nga lektorë jashtë departamentit. ^{12/13/14.}
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni	Konstatojmë se Departamenti i Pedagogjisë ka marrëdhënie bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit me institucione, si: Departamenti i Pedagogjisë në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Krakovës, Poloni ¹⁵ . Përmes këtij bashkëpunimi është arritur

¹²Evidencë 1 - Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, 2018

¹³Evidencë 3 - Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, 2018

¹⁴Evidencë 3.1 - Rregullore e Fakultetit të Edukimit, 2019

¹⁵Evidencë 119.1 - Marrëveshje bashkëpunimi në Mbështetje të Programit të Studimit të Ciklit të Tretë

vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	realizimi i ndryshimeve përmbytësore të programit, në funksion të ciklit të tretë të studimit në Doktoraturë. Janë nënshkruar, gjithashtu, edhe marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Durrës dhe Drejtorinë Rajonale Arsimore Durrës ¹⁶ .			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Evidentohet se IAL ka nënshkruar marrëveshje të posaçme, bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale me Bashkinë Durrës dhe Drejtorinë Rajonale Arsimore Durrës ¹⁷ .			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Theksojmë se Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Bashkinë Durrës dhe Drejtorinë Rajonale Arsimore Durrës kanë mundur zbatimin e praktikave profesionale në kopshtet e qytetit të Durrësit. Nga bisedat me stafin dhe me studentët evidentohet se praktikat ndiqen nga pedagogu mentor, në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe më pas realizon edhe një analizë lidhur me këto praktika.			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit I.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se Departamenti që mbulon programin ka krijuar një kulturë bashkëpunimi me instituonte dhe projekte që mbështesin formimin akademik dhe praktik të studentëve, ndaj GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁶Evidencë 67 - Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës

¹⁷Evidencë 67 - Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Rezulton se Programi i studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor” është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, si Ligji 80/2015 por dhe aktet e tjera ligjore. Programi zhvillohet konform Rregullores së Programit të Studimit^{18/19} dhe është i organizuar në lëndë dhe module, të cilat pasqyrohen në Planin Mësimor dhe me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)^{20/21}, ku gjithashtu ka he të dhëna të tjera mbi tipologjinë e lëndës, semestrin, vitin akademik dhe kriteret e frekuentimit etj.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose</p>	<p>Nga analiza e kurrikulës së Programi të Studimit²², si dhe në takimet me stafin dhe studentët, konstatohet se ky program synon të përgatisë specialistë të arsimit parashkollor, me kompetencat e domosdoshme për zhvillimin e një procesi mësimor, ku në fokus është të nxënë, modelet e ndryshme të mësimdhënies dhe të të nxënës, si dhe kërkimi didaktik dhe pedagogjik në edukim. Ky program synon formimin te studentët të kompetencave të domosdoshme teorike dhe praktike që mundësojnë ushtrimin e profesionit të mësuesisë në arsimin parashkollor, por dhe ky formim orientohet nga standardet e arsimit parashkollor për mësuesit në shërbim ^{23/24/25/26}. Gjithashtu programi mundëson dhe vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë master në disiplina që lidhen me fushën përkatëse. Një aspekt tjetër që konstatohet në këtë program studimi</p>

¹⁸ Evidencë-3.1-Rregullore FE, 2019. Neni 2d3, 42, 43

¹⁹ Evidencë-3.1.1 -Rregullore e Departamentit të Peadagogjise, 2019.

²⁰ Evidencë-12-Për Elementet e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-dt.24.1.2018.

²¹ Evidencë-30 -Dosja e Plotë e programit të studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor” 2019

²² Evidencë-3 -Rregullore UAMD, 2018. Neni 60-62

²³ Evidencë-3 -Rregullore UAMD, 2018. Neni 60-62

²⁴ Evidencë-30 -Dosja e Plotë e programit të studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor”

²⁵ Evidencë-12-Për Elementet e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-dt.24.1.2018.

²⁶ Evidencë-3.1.1.2 -Rregullore Bachelor në “Arsim Parashkollor”, 2019.

<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>është përditësimi i programeve lëndore çdo vit akademik, sidomos në drejtim të literaturës bashkëkohore, përkatëse^{27/28}. Nga ana tjetër, nga analiza e gruplëndëve bazë, formuese dhe ato të specialitetit në planin mësimor: <i>Rekomandojmë që të zëvendësohet lënda “Menaxhim klase” me një lëndë tjetër që lidhet ngushtë me menaxhimin e mjediseve të të nxënit dhe të grupeve të fëmijëve të arsimit parashkollor.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Evidentohet se ky program studimi nëpërmjet kurrikulës së tij është në përputhje me kërkesat ligjore të ndërtimit të planit mësimor, sepse Kategoria A që përfshin Lëndët Bazë –20% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 15%-20%, <i>ku në këtë grup bëjnë pjesë lëndët: Pedagogji, Psikologji, TIK në mësimdhënie, Menaxhim klase dhe Shkrim akademik.</i> ;</p> <p>Kategoria B që përfshin Lëndët Karakterizuese –51% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 50%-55%, <i>ku në këtë grup lëndësh bëjnë pjesë lëndët e didaktikave lëndore të gjuhës, matematikës, letërsisë, arteve, si dhe lëndë që lidhen me Komunikimin në fëmijërinë e hershme, Bota sociale e fëmijës, Pedagogji e edukimit familjar, edukimi qytetar dhe i të drejtave të fëmijës, Edukim shëndetsor dhe fizik, Metoda të mësimdhënies dhe Kurrikula.</i> ;</p> <p>Kategoria C që përfshin Lëndët Ndërdisciplinore /Integruese –14% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 12%-15%, <i>ku në këtë grup lëndësh bëjnë pjesë Edukimi gjithpërfshirës, Të nxënët me anë të lojës, por dhe lëndët me zgjedhje Pedagogji e dramatizimit, Gjuhë e huaj kineze.</i></p> <p>Kategoria D që përfshin Lëndët Plotësuese –11% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 10%-15%, <i>ku në këtë grup bëjnë pjesë Praktika dëgjimore, Gjuhë e huaj anglisht, si dhe praktikë aktive;</i></p> <p>Kategoria E që përfshin Lëndët Përmbyllëse –3% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 3%-5%, <i>e cila përfshin tezën e diplomës/provën finale.</i></p> <p>Konstatohet se kurrikula e këtij programi është hartuar duke mbajtur parasysh që çdo lëndë/modul të zërë vendin që i takon në kuadër të veprimtarive formuese.²⁹</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit kurrikular të Programit të studimit evidentohet se ai ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin</p>

²⁷ Evidencë-3.1.1.2 -Rregullore Bachelor në “Arsim Parashkollor”, 2019.

²⁹ Evidencë-12-Për elementet e programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-dt.24.1.2018.

<p>ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>e praktikës profesionale, e cila ka një peshë specifike prej 12 ECTS. Studentët dërgohen pranë institucioneve arsimore, të përzgjedhura dhe të përcaktuara nga marrëveshjet e nënshkuara mes institucionit UAMD me ZVAP Durrës dhe me Bashkinë Durrës. Rezulton se programi në fjalë është i ndërtuar në mënyrë që studentët të kenë mundësi të ndjekin praktikën përgjatë dy semestrave³⁰, të ndarë ndërmjet orëve në auditor dhe orëve në institucione të ndryshme arsimore të sektorit publik^{31/32}. Konstatohet se ky program nuk përmban praktikë laboratorike ose klinike, por praktikë degjimore në vitin e dytë dhe praktikë aktive në vitin e tretë, e cila zhillohet në kopshte.</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacioni të kurrikulës së programit të studimit evidentohet se ai bazohet tërësisht në vendimet dhe udhëzimet e ardhura nga MAS për institucionet e Arsimit të Lartë^{33/34/35/36}. Në fund të çdo viti akademik njësia bazë miraton kuotat për studentët brenda vendit, program i dytë studimi, transferim studimesh, shtetas të huaj, me statusin e jetimit, persona me AK si dhe romë e egjiptianë, kategoritë e veçanta të studentëve (me status jetim, me ndihmë ekonomike, me prindër invalidë, mesatare 9-10), kuota që dërgohen për miratim në Senat nga Dekanati e më pas bëhet shpallja në faqen zyrtare të UAMD-së, ndërsa forma e studimit është me kohë të plotë³⁷.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nga analiza e planit mësimor të programit dhe nga diskutimi me stafin e departamentit konstatohet se Programi i studimit Bachelor në "Arsim Parashkollor", është ofruar për herë të parë për studentët në vitin akademik 2013-2014 dhe vit pas viti ka pësuar ndryshime. Krahasuar me vitin e parë të fillimit me kurrikulën në ditët e sotme vihet re se programet lëndore ruajnë të njëjtin emërtim ose në të njëjtën fushë studimi dhe ai ka një përmbajtje të ngjashme me to mbi 70%.</p> <p><i>Rekomandojmë që, pas akreditimit, të rishihet plani mësimor nën frymën e sugjerimeve të grupeve të punës së MAS për përafrimin e kurrikulës së studimeve bachelor në mësuesi në arsimin parashkollor.</i></p>

³⁰ Evidencë-101-Manuali/Rregullore e Praktikës, 2019.

³¹ Evidencë-101-Manual i Praktikës, Bachelor 2019.

³² Evidencë-67- Marrëveshje Bashkëpunimi me ZVA-Durrës.

³³ Evidencë-12-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr. - 41-dt.24.1.2018.

³⁴ Evidencë-3-Rregullore UAMD, 2018. Neni 42, 45.

³⁵ Evidencë-3.1 -Rregullore FE, 2019. Seksioni IV, 24.

³⁶ Evidencë-3.1.1.1-Rregullore Bachelor në "Arsim Fillor", 2019.

³⁷ Evidencë-3-Rregullore UAMD, 2018. Neni 42, 45.

<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe nga verifikimi me takimin me drejtuesen e departamentit konstatohet se programi i studimit është i ndërtuar në përputhje me kriteret e kërkuara dhe sipas bazës ligjore përkatëse. Bazuar në vendimin Nr. 310, datë 11.05.2022” Hartimi i dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 dhe direktivave ndërkombëtare Evropiane³⁸ UAMD ka hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve që ofron, ku programi në fjalë mban kodin 63BA011IS³⁹.</p>			
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Konstatohet se ky program studimi ofrohet vetëm nga Departamenti i Pedagogjisë në Fakultetin e Edukimit në UAMD dhe nuk është program i përbashkët studimi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit II.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi i studimit përmbush kriteret ligjore për ndërtimin dhe zbatimin e kurrikulës së tij, ofron formim akademik dhe praktik të domosdoshëm, ndërsa plani mësimor dhe përmbajtja e tij, me anë të lëndëve bazë, të formimit profesional, atij me zgjedhje, apo detyrime përmbyllëse etj, respekton kriteret ligjore, si dhe ai është në përshatje dhe me ngjashmëri me programe të këtij lloji që ofrojnë universitete të tjera në vend. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, nga evidencat përkatëse që e shoqërojnë, por dhe nga takimet me dekanin, me</p>

³⁸ Evidencë-63-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, datë. 22.07.2015.

³⁹ Evidencë-11.1-Kodifikimi i Programeve FE.

për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Përgjegjësini e departamentit dhe me stafin që mbulon programin rezultojn se njësitë bazë dhe kryesore funksionojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë si dhe me Statutin e institucionit. Fakulteti i Edukimit si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 7 njësi bazë:

1. Departamenti i Gjuhës Shqipe;
2. Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
3. Departamenti i Letërsisë;
4. Departamenti i Pedagogjisë;
5. Departamenti i Psikologjisë;
6. Departamenti i Sociologjisë;
7. Qendra e Edukimit në Vazhdim;

Departamenti i Pedagogjisë është drejtpërdrejt përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor” i cili përmbush të gjitha detyrimet ligjore⁴⁰ për organizimin dhe strukturën akademike⁴¹, stafet akademike si dhe vlerësimin e akreditimit⁴². Njësia bazë ka mision dhe vizion të qartë, të cilat i bazon në politikat dhe planin strategjik të institucionit dhe kjo mbështetet nga Rregullorja e studimit⁴³ në nivel fakulteti dhe dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për arsimin e lartë.⁴⁴ Si akreditim i parë identifikohet një përpjekje dhe motivim për ta shndërruar vetëvlerësimin një kulturë pune, sepse Departamenti i Pedagogjisë kishte përcaktuar grupin e punës për të bërë realizimin e vlerësimit të brendshëm, përgatitjen e raportit, përgatitjen e dokumentacionit përkatës në një bashkëpunim të ngushtë me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Referuar dok (Tabela të skanuara akreditim), të dhënat e departamentit për tre vite akademike janë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Pedagogjisë					
	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	1	-	1	-	1	-
Prof. Asoc.	7	-	7	-	7	-
Dr/Phd	3	2	3	2	3	2
Msc.	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	11	2	11	2	11	2

⁴⁰ Evidencë-1-Statuti UAMD, 2018. Kreu VII, Neni 77 - 81

⁴¹ Evidencë-50-Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe me Kontratë në Njësinë Bazë, 2022-2023

⁴² Evidencë-61-Kodi i Cilësisë.

⁴³ Evidencë-3.1.1.2 -Rregullore Bachelor në “Arsim Parashkollor”, 2019.

⁴⁴ Evidencë-12-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-dt.24.1.2018.

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Konstatohet nga analiza e kurrikulës, e ngarkesës mësimore të stafit PAE/PAK, nga takimi me stafin, nga takimi me studentët, se zbatimi i programit përmbush kriteret ligjore për raportin 70%-30% staf i brendshëm/i jashtëm. Nga ana tjetër, nga takimet me stafin mbështetës dhe me studentët, rezulton se studentët mbështeten nga një personel ndihmës gjatë procesit mësimor dhe veprimtarive që realizohen në këtë program studimi.⁴⁵ Lidhur me realizimin e praktikave mësimore konstatohet se departamenti nuk angazhon personel akademik ndihmës^{46/47} për realizimin e praktikave mësimore, sepe ngarkesa mësimore është e përcaktuar për stafin e tij/PAE.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga takimi me stafin që mbulon programin konstatohet se rolin e koordinatorit të këtij programi studimi, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit, e realizon përgjegjësjë e departamentit me të gjitha përgjegjësitë përkatëse. Ajo përcakton pedagogët përgjegjës (tutorët) sipas kurseve, të cilët janë pedagogë që japin mësim pranë këtij programi në një vit akademik⁴⁸</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit II.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se IAL ka njësi kryesore dhe bazë funksionale konform akteve ligjore dhe nënligjore që mbulojnë këtë program studimi, zhvillon dhe realizon praktikë profesionale të efektshme për studentët e këtij programi studimi, bën përpjekje për instalimin e kulturës së vetëvlerësimit, si dhe ka përgjegjësi dhe detyra të ndara qartë dhe të zbatueshme në departament për lehtësimin e studentëve. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi II.3

⁴⁵ Evidencë-52-Ngarkesa Mësimore e Personelit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit.

⁴⁶ Evidencë-1-Statuti UAMD, 2018. Kreu VI, Neni 72.

⁴⁷Evidencë-3.1 -Rregullore FE, 2019. Kreu X, Neni 80.

⁴⁸ Evidencë-3.1.1 -Rregullore e Departamenti të Pedagogjisë, 2019.

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga takimi me stafin dhe me Përgjegjësen e Departamentit konstatojmë se Njësia kryesore-Fakulteti i Edukimit dhe Njësia bazë-Departamenti i Pedagogjisë disponojnë dokumentacionin e domosdoshëm, institucional për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit ^{49/50/51} . Ato gjenden të pasqyruara në Rregulloren e UAMD-së, Rregulloren e Fakultetit të Edukimit, Rregulloren e Departamentit të Pedagogjisë, Rregulloren e Programit të Studimit, si dhe në kurrikulën e programit të studimit, si: Plani mësimor, programet lëndore, të cilat janë grupuar sipas kategorive të veprimtarive formuese.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit, përkatësisht të planit mësimor dhe të programeve lëndore evidentohen informacionet e nevojshme për kreditet e lëndëve apo moduleve, ngarkesën javore e ngarkesën e përgjithshme, mësimore në auditor dhe detyrimet në përfundim të lëndës/modulit (provim/firmë). Programi i studimit Bachelor ofron në mënyrë të detajuar lëndët dhe shtrirjen përgjatë vitit akademik, si dhe paraqitet për çdo lëndë kohështrirje vjetore apo semestrare, duke përcaktuar javët mësimore, orët e leksioneve, orët e seminareve, praktikave apo laboratorëve, tipologjinë e lëndës, pedagogët e përfshirë në këtë program studimi si dhe kreditet përkatëse për secilën lëndë/modul ⁵² .
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit, nga takimi me stafin e tij dhe studentët vihet re se studentët kanë mundësi që të njihen me përmbajtjen e tij në dokumentet e paraqitura online në faqen e internetit të IAL https://uamd.edu.al/arsim-parashkollor/ , por dhe në Rregulloren e së UAMD-së, ditën e parë të shkollës, ku studentët njihen me strukturën, kurrikulën, detyrimet. Po ashtu secili pedagog bën njohjen me detyrimet dhe kërkesat që lidhen me lëndën specifike në fillim të lëndës, sipas semestrave ⁵³ .
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë	Siç është cituar më lart konstatojmë se dokumentacioni i kurrikulës së programit paraqet në mënyrë të detajuar lëndët, shtrirjen përgjatë vitit akademik, orët e seminareve, praktikave apo laboratoreve, tipologjinë e lëndës, pedagogët e përfshirë në këtë program studimi si dhe kreditet përkatëse. Programet lëndore paraqesin gjithashtu një

⁴⁹ Evidencë-32-Plani Mësimor për Programin e studimit Bachelor në "Parashkollor"

⁵⁰ Evidencë-3.1 -Rregullore FE, 2019.

⁵¹ Evidencë-3.1.1.2 -Rregullore Bachelor në "Arsim Parashkollor", 2019.

⁵² Evidencë-33-Plani Mësimor për Programin Bachelor në "Arsim Parashkollor".

⁵³ Evidencë-3.1.1.2 -Rregullore Bachelor në "Arsim Parashkollor", 2019

për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	përmbajtje të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet kyç, temat, format e kontrollit dhe literaturën ⁵⁴ .			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga takimi me stafin që mbulon programin konstatojmë se ky program studimi ka qëndrueshmëri, sepse përvoja e tij është 10 vite, por herë pas here ai është pasuruar ose përmirësuar qoftë në përmbajtjen, por dhe në aspektin metodologjik. Programi ka krijuar lidhje dhe me standardet zyrtare të arsimit parashkollor për grupmoshat 4-6 vjeç, por ndjehet nevoja e përfshirjes së stafit në reformat dhe ndryshimet kurikulare që zbaton MAS në arsimin parashkollor ⁵⁵ .			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit II.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi i studimit është hartuar dhe zbatohet konform kriterëve ligjore, njësia bazë ka arkivë për dokumentacionin e programit, studentët informohen online dhe në auditor lidhur me përmbajtjen e programit, si dhe programi dëshmon qëndrueshmëri dhe përmirësime të nevojshme gjatë zbatimit të tij. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit, nga takimi me stafin e tij dhe studentët konstatojmë se Programi i studimit u ofron studentëve orë të nevojshme e të mjaftueshme teorike e praktike për aftësimin e zhvillimin e tyre profesional për punësimin e tyre të

⁵⁴ Evidencë-32-Plani Mësimor për Programin e studimit Bachelor në "Parashkollor"

⁵⁵ Evidencë-126.1 - Silabuset e Lëndëve/Programet lëndore në Programin e studimit Bachelor në "Arsim Parashkollor".

<p>thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>ardhshëm. Programi i studimit bazohet në një kurrikul me ngjashmëri me programet bashkëkohore të së njëjtës fushë që ofrohen nga universitete të tjera në vend. Konstatohet se programi ofron jo vetëm orë në auditor, por edhe orë në laboratore e në terren përmes praktikës aktive e pasive në shkolla Konkretisht programi përmban 855-orë leksione; 1055-orë seminare; 240-orë praktike në shkollë; laborator 60-orë mësimore, diploma/provim formimi 150 orë, me një total prej 2360 orë në auditor gjatë tre viteve akademike^{56/57/58}.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Siç është cituar më lart konstatohet se dokumentacioni i kurrikulës së programit paraqet në mënyrë të detajuar lëndët, shtrirjen përgjatë vitit akademik, orët e seminareve, praktikave apo laboratoreve, tipologjinë e lëndës, pedagogët e përfshirë në këtë program studimi si dhe kreditet përkatëse. Programet lëndore paraqesin gjithashtu një përmbajtje të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet kyç, temat, format e kontrollit dhe literaturën⁵⁹.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga analiza e kurrikulës së programit, nga takimi me stafin dhe me studentët evidentohet se ky program ka 180 kredite të ndara në 3 vite e sipas lëndëve e moduleve, në përputhje me profilin e programit të studimit. Lëndët në programe kanë ngjashmëri edhe me programet e universiteteve në vend, kjo bazuar edhe në Ligjin e e Arsimit të Lartë, neni 86. Raporti teori-praktikë është i arsyeshëm dhe i pranueshëm për formimin e domosdoshëm të studentëve⁶⁰.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit rezultojnë se ai është ndërtuar në përputhje me kriteret ligjore. Konkretisht ai përmban:</p> <p>Disiplina të formimit të përgjithshëm (simboli A-27 ECTS);</p> <p>Të formimit karakterizues (simboli B - 103 ECTS);</p> <p>Të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese, (simboli C-18 ECTS);</p> <p>Disiplinat me zgjedhje (simboli D -26 ECTS);</p> <p>Njohuri të tjera formuese (simboli E -6 ECTS).</p>

⁵⁶Evidencë-30 -Dosja e Plotë e programit të studimit Bachelor në "Arsim Parashkollor", 2019

⁵⁷Evidencë-16-1-Studimi i Tregut të Punës, Departamenti i Pedagogjisë, 2013.

⁵⁸Evidencë-33-Plani Mësimor për Programin Bachelor në "Arsim Parashkollor".

⁵⁹Evidencë-32-Plani Mësimor për Programin e studimit Bachelor në "Parashkollor"

⁶⁰Evidencë-30-Dosja e Plotë e programit të studimit Bachelor në "Arsim arashkollor", 2019.

	Nga takimi me studentët ata shprehën se ka patur ndonjë veprimtari mobiliteti ^{61/62} .
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga takimi me stafin e programit rezulton se bëhen përpjekje për përditësimin e përmbajtjes së kurrikulës në përputhje me ndryshimet dhe risitë sidomos në literaturën e detyruar dhe ndihmëse. Kjo literaturë përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke iu referuar botimeve të 5 viteve të fundit. Literatura ofrohet në gjuhën angleze dhe gjendet në bibliotekat online dhe bibliotekën e fakultetit të Edukimit ^{63/64/65/66} . <i>Si ekip i RVJ: Rekomandojmë që, pas akreditimit, plani mësimor/programet lëndore të përmirësohen sipas rekomandimeve që kanë dhënë grupet e punës në MAS për përafrimin e kurrikulës së mësuesisë në arsimin parashkollor.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Nga shqyrtimi i kurrikulës së programit identifikohet se ai ofron njohuri, aftësi e kompetenca për t'i bërë ata mësues të aftë profesionalisht dhe nxënës gjatë gjithë jetës, si dhe i referohen edhe Kompetencave të Arsimit Parashkollor sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parashkollor ⁶⁷ .
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga analiza e kurrikulës së këtij programi dhe e përshtatshmërisë së tij me aktet ligjore, si dhe nga takimi me stafin konstatohet se ky program mundëson për studentët punësim të menjëhershëm në tregun e punës si mësues/e kopshti/arsimi parashkollor ⁶⁸ .
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-7 të standardit II.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi i studimit është hartuar dhe zbatohet konform kriterëve ligjore dhe vëren se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe Kornizës Shqiptare të Kurrikulës së Arsimit Parashkollor, si dhe synon formim të kompetencave në</i>

⁶¹ Evidencë-68-Të Dhëna mbi Mobilitetin e Stafit Akademik dhe Studentëve UAMD.

⁶² Evidencë-59 -Kriteret e Transferimit të studimeve

⁶³ Evidencë-3-Rregullore UAMD, 2018.

⁶⁴ Evidencë-3.1-Rregullore FE, 2019.

⁶⁵ Evidencë-3.1.1 -Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë, 2019.

⁶⁶ Evidencë-3.1.1.2 -Rregullore Bachelor në "Arsim Parashkollor", 2019.

⁶⁷ Evidencë-30 -Dosja e Plotë e programit të studimit Bachelor në "Arsim Parashkollor"2019.

⁶⁸ Evidencë-3.1.1.2 -Rregullore Bachelor në "Arsim Parashkollor", 2019.

	<i>përputhje me kërkesat e tregut të punës. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nga takimi me stafin e programit, me studentët, me përfaqësues të NJSBC-së konstatohet se Departamenti synon përmirësimin e vazhdueshëm të programit bazuar në “Planin e Zhvillimit Strategjik” të UAMD. Ky plan paraqet numrin e projekteve me ndikim rajonal dhe për komunitetin si dhe rritjen e numrit të veprimtarive të përbashkëta me organizime me Alumnin që ndikojnë në komunitet ⁶⁹ . Vihet re se Departamenti i Pedagogjisë përfshin dhe studente në panairin e karrierës apo të ndërveprimit praktik me palët e treta si pjesë e transferimit të njohurive si dhe punësimit të tyre. ^{70/71/72/73} .
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të	Nga takimi me stafin, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve dhe me studentët rezultojnë se ata informohen me nevojat e tregut të punës sidomos në ZVAP e qarkut Durrës, u merret mendimi lidhur me përmirësimin e programit të studimit me anë të koordinatorit të programit, ndërsa studentët janë të përfaqësuar në Senat dhe në Këshillin studentor ^{74/75/76} .

⁶⁹ Evidencë-2-Plani Strategjik UAMD 2020-2025

⁷⁰ Evidencë-21 -Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës,

⁷¹ Evidencë-22-Shoqata Alumni UAMD.

⁷² Evidencë-23-Takime Alumni UAMD.

⁷³ Evidencë-25- Njoftime për Punësim të Studentëve dhe Alumni

⁷⁴ Evidencë-1 -Statuti UAMD, 2018. Kreu IX, Neni 88.

⁷⁵ Evidencë-13-Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilesisë.

⁷⁶ Evidencë-14 -Rezultate mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucional, 2020-2021, 2021-2022.

përmirësimin të programit të studimit.									
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Nga shqyrtimi i programeve lëndore dhe nga takimi me stafin rezultojnë se programi i studimit ka reflektuar zbatimin e standardeve zyrtare të në rrafshin e përmbajtjes shkencore dhe të asaj didaktike sespe bashkëpunohet me ASCAP, me kopshte publike dhe jopublike. Nga ana tjetër departamenti realizon dhe veprimtari trajnuese dhe punë në grupe për të përmirësuar në vijimësi metodat dhe teknikat që lidhen me edukimin e fëmijëve të arsimit parashkollor, por dhe për përmirësimin e vijueshëm të programit ⁷⁷ .								
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit II.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

⁷⁷ Evidencë-I-Plani Strategjik UAMD 2020 - 2025.

<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore, nga takimet me stafin e programit dhe me studentët evidentohet përdorimi i formave dhe rrugëve të larmishme të proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënit, të tilla si: leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat e kursit/ esetë, praktikat profesionale, orët e hapura, etj. Evidentohen veprimtari mësimore që ndahen në: mësim në auditor, si leksione, orë të hapura, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor. Evidentojmë se procesi i mësimdhënies dhe të të nxënit realizohet nga lektorët duke përdorur mjete audio vizuale si laptop-e, video - projektorë, të cilët përdoren dhe nga studentët gjatë prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup apo dhe ato individuale. Stafi akademik shprehet se Mësimdhënia me në qendër studentin është fokusi i orëve mësimore në programin Bachelor “Arsim Parashkollor” ku lektori shërben si një urë lidhëse mes studentit dhe përgatitjes së tyre si mësues të arsimit parashkollor në të ardhmen.^{78/79/80}.Kontsatohet se rëndësi i është kushtuar dhe përdorimit të teknologjisë në funksion të mësimit online nga stafi akademik dhe studentët për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19 ku gjatë mësimdhënies online ka patur vështirësi në fillim, të cilat hap pas hapi kanë mundësuar që procesi mësimor të finalizohet me sukses.⁸¹</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit konstatojmë se ata respektojnë diversitetin dhe nevojat e ndryshme të studentëve nëpërmjet zbatimit të formave, mënyrave dhe metodave alternative të mësimdhënies dhe të nxënit në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit, etj. Nga analiza e programit të studimit, evidentohet se ky program ofron një larmi lëndësh e fushash studimi gjë që e orienton dhe e drejton personelin akademik drejt formave, mënyrave, metodave e mundësive alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Në IAL vumë re re ka infrastrukturë të favorshme për levizjen dhe akomodimin në shkollë të studentëve me nevoja të veçanta⁸²</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e</p>	<p>Nga takimi me stafin e Departamentit evidentojmë se Njësia bazë mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave profesionale të mësimdhënies. Konstatojmë se stafi akademik bën</p>

⁷⁸ Evidencë-1-Statuti UAMD, 2018, Kreu VII, Neni 77.

⁷⁹ Evidencë-9- Strategjia e Departamentit të Pedagogjisë 2022-2025.

⁸⁰ Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

⁸¹ Evidencë-97-Vendim Rektorati për marrjen e masave gjatë pandemisë, Vendim për përdorimin e platformave online.

⁸² Evidencë-70-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit.

<p>kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>përpjekje dhe është pjesë e e programeve të ndryshme për mobilitet të stafit akademik në universitete evropiane, kjo e vërtetuar dhe me anë të marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit, por dhe me anë të certifikatave që pedagogët kanë marrë në këto shkëmbime për lektrime dhe përvoja në procesin mësimor tek universitetet e huaja⁸³.Evidentojmë se organizohen konferenca⁸⁴ dhe seminare shkencore në bashkëpunim me universitete brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga takimet me pedagogët, me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe me studentët konstatohet se personeli akademik zhvillon lëndë në përputhje me kualifikimin dhe kërkimin shkencor të tyre.⁸⁵ Konstatohet se mësimdhënia është përmirësuar hap pas hapi duke u bazuar te të dhënat e mbledhur nga studentët sipas të cilave ata përfshihen në dhënien e mendimit të tyre në leksione dhe veçanarisht në seminare, por dhe për zhvillimin e detyrave të kursit, përfshirjen në projekte dhe nxitjen për punë kërkimore.Nga biseda me pedagogët evidentohet se ata krijojnë marrëdhënie reciproke bashkëpunimi me studentët në të mirë të tyre.Evidentohet se stafi akademik komunikon rregullisht me studentët me anë të adresave të e-mailit, në oraret e priteve të përcaktuara dhe të shpallura në departament nga secili pedagog.⁸⁶</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Nga takimet me stafin dhe me studentët konstatohet se pedagogët vlerësojnë shumë feedback-un e studentëve që merret me anë të pyetësorëve dhe i mbajnë në konsideratë për të përmirësuar dhe për të sjellë risi në mësimdhënie me anë të përdorimit të metodologjive dhe teknologjive të mësimdhënies. Departamenti realizon vlerësimin e pedagogëve dhe kjo konsiderohet një rrugë e efektshme për përmirësim të vijueshëm⁸⁷.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të</p>	<p>Nga takimi me dekanin dhe me përfaqësues të NJSBC konstatohet se IAL-ja bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, neni 37, pika 1 dhe neni 38, si dhe nenet 61,62,109,155 të Rregullores së brendshme të vlerësimit të performancës se pedagogut në UAMD, kryhet procesi në mënyrë anonime nga studentët me anë të</p>

⁸³ Evidencë-68-Mobilitetet e Stafit Akademik dhe Studentëve UAMD.

⁸⁴ Evidencë-81-Konferencat studentore të Organizuar nga Njësia Bazë.

⁸⁵ Evidencë-79-CV Stafit Akademik.

⁸⁶ Evidencë-24.1-Orari i konsultimeve me studentët.

⁸⁷Evidencë-71 -Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët

<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>formularëve të vlerësimit të performancës së lektorëve në auditor dhe efikasitetit të metodave që përdoren prej tyre në mësimdhënie. Vumë re se studentët kanë mundësinë të japin vlerësimin e tyre mbi procesin e mësimdhënies dhe gjithashtu të bëjnë sugjerime.^{88/89/ 90} dhe konstatojmë se vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore. Pas përpunimit të të dhënave dhe nxjerrjes së rezultateve dhe bërjes me dije njësisë bazë dhe lektorëve përkatës, bëhet reflektimi i mendimeve dhe sugjerimeve të tyre pranë departamentit të pedagogjisë.^{91 92 93} Konstatojmë se një praktikë e mirë që ndjek institucioni, është edhe rimbursimi i shpenzimeve për kërkimin shkencor, publikimet dhe pjesëmarrjet në konferenca brenda dhe jashtë vendit, si dhe pjesëmarrja e pedagogëve të këtij departamenti në kuadër të programit Erasmus+ apo në projekte të tjera kërkimore shkencore.⁹⁴</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit III.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve të planifikuara. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, nga diskutimi me pedagogë dhe me studentë evidentojmë se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, si dhe sjelljet etike përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit</p>

⁸⁸ Evidencë-71 -Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët.

⁸⁹ Evidencë-71.1-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2020-2021; 2021-2022.

⁹⁰ Evidencë-71.2-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2022-2023.

⁹¹ Evidencë-129-Raport vlerësimi mbi performancën e lektoreve efektive (PAE) 2020-2021.

⁹² Evidencë-129.1-Raport vlerësimi mbi performancën e lektorëve efektive (PAE) 2021-2022.

⁹³ Evidencë-129.2-Raport vlerësimi mbi performancën e lektorëve efektive (PAE) 2022-2023.

⁹⁴ Evidencë-68 -Mobilitetet e Stafit Akademik dhe Studenteve UAMD

<p>profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>të UAMD-së, por ato bëhen publike dhe u komunikohen studentëve nga ana e pedagogëve të secilës lëndë/modul në fillim të lëndës⁹⁵.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga nga diskutimi me pedagogë dhe me studentë evidentojmë se ditën e parë të zhvillimit të mësimit për çdo lëndë titullarët e tyre u prezantojnë studentëve metodologjinë e testimit (vlerësimin e vazhduar, vlerësimin në provim) që lidhen me vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Anëtarët e stafit akademik prezantojnë para studentëve të gjitha elementet e lartpërmendura; marrin pyetje dhe reagime dhe ngarkojnë në sistem temat që do të zhvillohen për të gjitha javët. Ky informacion u mundësohet studentëve dhe gjatë Javës së parë orientimit, por dhe gjatë gjithë vitit akademik⁹⁶.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të studimit⁹⁷, nga bisedat me stafin dhe me studentët konstatojmë se mënyra e vlerësimit të studentëve bazohet në vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar/provimin e lëndës. Rezulton se UAMD përdor forma të vlerësimit të vijueshëm dhe atij përfundimtar, sipas asaj që përcaktohet në Rregulloren e Programit, por dhe në secilin programin lëndor të çdo lëndë apo moduli ku studenti vlerësohet sipas këtyre komponentëve:</p> <p>400 pikë provimi i ndërmjetëm, 500 pikë provimi përfundimtar 100 pikë detyra e kursit.⁹⁸</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Siç është përmenduar dhe më lart personeli akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënie që kanë në fokus studentin, si: demonstrime, ligjërata, vizita në kopshte, veprimtari praktike, punë në grupe, kërkime në internet, etj., sipas tematikave dhe fushës që lëvtron. Konstatojmë se stafi UAMD është trajnuar për të përdorur platformat elektronike Moodle dhe Clean Score⁹⁹, duke garantuar shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm, të shpejtë të vlerësimit për studentët.</p>

⁹⁵Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

⁹⁶Evidencë-24-Java e Orientimit dhe guida e studentit.

⁹⁷Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

⁹⁸Evidencë-42.2-Model Syllabusi sipas VKM-së nr.41.

⁹⁹Evidencë-96-Përdorimi i CLEANSCORE në Testime.

<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore dhe nga bisedat me stafin akademik rezultojnë se format dhe metodat e mësimdhënies variojnë në varësi të mënyrës se si çdo pedagog/e koncepton organizimin e lëndës/modulit, ku secili prej tyre përfshin në programin e tij forma të larmishme të përfshirjes së studentëve si: detyra kursi, projekte, punë në grupe, etj¹⁰⁰.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit III.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL zbaton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.3</p>	
<p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Rregullores së UAMD) dhe nga takimet me stafin akademik dhe me studentë konstatohet se testimi dhe vlerësimi i njohurive, i dijeve dhe aftësive profesionale për studentët realizohet gjatë gjithë vitit akademik nëpërmjet këtyre komponentëve: 400 pikë provimi i ndërmjetëm, 500 pikë provimi përfundimtar dhe 100 pikë detyra e kursit.¹⁰¹ Format e kontrollit të</p>

¹⁰⁰Evidencë- Evidencë-42.2-Model Syllabusi sipas VKM-së nr.41.

¹⁰¹Evidencë-42.2-Model Syllabusi sipas VKM-së nr.41.

parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	njohurive paraqiten në një tabelë njëse, e cila e ka njësoj ndarjen për të gjitha programet lëndore/syllabuset.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Konstatohet se UAMD po zbaton sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve, në sajë të projektit Clean Score të financuar nga AADF ¹⁰² .
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Rregullores së UAMD) dhe nga takimet me stafin akademik dhe me studentë konstatohet se Vlerësimi përfundimtar i lëndës është rezultat i dy përbërësve që lidhen me vlerësimin e vazhduar me përbërësit përkatës, sipas programit lëndor (syllabusit), si dhe vlerësimit në provim, nëse lënda është provim. Nëse lënda është firmë, forma e shlyerjes së firmës bazohet në Rregulloren e programit të studimit. Rezulton se Përgjegjësi i departamentit të pedagogjisë siguron që në auditorin ku zhvillohet provimi të jenë së paku 2 pedagogë gjatë sezonit të provimit, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit, ndërsa anëtari tjetër asiston si pjesëtar i të njëjtit grup mësimor, ku bën pjesë lënda, ndërsa në sezonet e riprovimeve vlerësimi bëhet nga një komision me tre lektorë të të njëjtit grup mësimor. Nga ana tjetër Titullari i lëndës/modulit është kryetar i komisionit ndërsa dy lektorët e tjerë janë anëtarë të tij. ¹⁰³ Tezat miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili kontrollon nivelin e përmbajtjes së tezës, shkallën e vështirësisë së saj, kohëzgjatjen e provimit mbështetur në pyetjet e përfshira në provim, shpërndarjen e pikëve për secilën pyetje, etj. Teza e provimit është 400 pikë për provimin e ndërmjetëm, 500 pikë për provimin përfundimtar dhe 100 pikë për detyrën e kursit/projekti, pra 1000 pikë në total. Teza për riprovimet është 1000 pikëshe. ¹⁰⁴
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Rregullores së UAMD) dhe nga takimet me stafin akademik dhe me studentë konstatohet se Vlerësimi i njohurive të studentëve kryhet nëpërmjet fazave të ndryshme të kontrollit gjatë semestrit, si: provimi i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim final. Ky vlerësim shoqërohet me komente që lidhen dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Korigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit. Rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda 7 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni bën

¹⁰²Evidencë-96-Përdorimi i CLEANSORE në Testime.

¹⁰³ Evidencë-3.1-Rregullore FE, 2019.

¹⁰⁴ Evidencë-3-Rregullore UAMD, 2018.

<p>studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>ballafaqimin me studentët ditën e caktuar të dhënies së rezultateve. Parashikohen procedura për ankimimin e studentëve lidhur me korigjimin e provimeve, ku sipas rregullores, studentëve i jepet një afat një ditor (brenda ditës së shpalljes së rezultateve) për të rishikuar provimin, për të kuptuar ku ka gabuar dhe për t'u këshilluar me pedagogun në vijim¹⁰⁵.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Nga analiza e Rregullores së UAMD dhe ajo e programit, por dhe nga diskutimet me pedagogët dhe studentët kontatojmë se në provime dhe në paraqitje të temave dhe detyrave zbatohen rregulla dhe procese që lidhen me monitorimin dhe me zbatimin etik, antiplagjiaturë të krijimeve të studentëve. Nga ana tjetër zbatohen me rreptësi rregulla që persona të jashtëm nuk lejohen në sallën e provimit, ku komisioni ka të drejtë të ndërpresë provimin dhe të kërkojë ndihmën e të gjitha instancave (deri tek organet e ruajtjes së rendit publik) për rivendosjen e kushteve normale të zhvillimit të provimit. Në rastet kur provimi është me zë, studentët që deri në atë çast e kanë kryer provimin, nuk provohen më. Studenti konsiderohet mbetës në provim kur shkel elementet e Kodit të Etikës¹⁰⁶, sipas përcaktimeve të detajuara në rregullore (detyrimi i studentëve për të mos kopjuar në provime, ose punën e dikujt tjetër, për të mos fabrikuar të dhëna dhe respektuar dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë dhe personelit akademik e atij mbështetës¹⁰⁷</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit që lidhet me vlerësimin e studentëve por dhe nga bisedat me pedagogë dhe me studentë konstatojmë se studentët informohen në kohë për arritjet e tyre (ata presin deri në 3 ditë/72 orë për marrjen e notës). Ekzistojnë procedura të zbatueshme për ankimim, kurse rezultatet e kontrollit të dijeve për vlerësimin e vazhduar të studentit jepen orën e fundit të seminarit.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Siç është përmenduar dhe më lart pas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamertuar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar dekanit të fakultetit Kërkesa pastaj i dërgohet departamentit, i cili krijon një komision ad-hoc për rivlerësimin e studentit dhe vë në dijeni pedagogun e lëndës¹⁰⁸.</p> <p>Nga bisedat me studentët konstatojmë se personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve të tyre, në mënyrë që të sigurohet transparenca e</p>

¹⁰⁵ Evidencë-3-Rregullore UAMD, 2018.

¹⁰⁶ Evidencë-4-Kodi i Etikës UAMD.

¹⁰⁷ Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

¹⁰⁸ Evidencë-3.1-Rregullore e FE 2019.

<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prani të personelit akademik të kursit, për t'u ballafaquar me rezultatet e tyre dhe për të marrë sqarimet e duhura. Në rastin e provimit përfundimtar personeli akademik i kursit cakton datën dhe orën e takimit me studentët, për të bërë të ditur rezultatet që ata kanë marrë në provim, e cila duhet të jetë, jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të mësipërme dhe duhet t'i dorëzojë procesverbalet e firmosura dhe provimet të mbyllura në një zarf, në sekretarinë mësimore, sipas procedurës së përcaktuar dhe mbahen në ruajtje sipas afateve të përcaktuara në rregulloren "Për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit të brendshëm".</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit III.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti, duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.4</p>	
<p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Nga diskutimi me stafin akademik të programit konstatohet se programi zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve, duke iu mundësuar atyre kompetencat e domosdoshme për tregun e punës. Staf i programit konkludon se programi zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve, sepse ky proces bëhet i mundur nëpërmjet mënyrës se si çdo pedagog/e koncepton organizimin e lëndës/modulit, ku secili/a prej tyre përfshin në programin e tij/të saj forma të larmishme të përfshirjes së studentëve, si: detyra kursi, projekte, punë në grupe, etj¹⁰⁹.</p>

¹⁰⁹ Evidencë-3.1.1.2.Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Nga analiza e programeve lëndore, e planit mësimor dhe diskutimi me pedagogët e programit theksohet se programi i studimit është hartuar në mënyrë të tillë që studentët të marrin njohuri teorike dhe praktike për veprimtari të ndryshme në fushën që parashikon programi. Në kurrikul janë përfshirë gjerësisht lëndë dhe module që mundësojnë formimin bazë (përgatitje metodologjike), lëndë karakterizuese dhe përgatitje për disiplinën shkencore. Mendojmë se ky program garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, atë humane e sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj) përmes lëndëve që ajo ofron, si: Teknologji në mësimdhënie, Etikë profesionale e mësuesit, Edukimi dhe mendimi krijues; Gjuhë e huaj anglisht/kineze me zgjedhje, Edukim Qytetar dhe të Drejtat e Njeriut, etj¹¹⁰.</p> <p><i>Rekomandojmë që të zëvendësohet lënda “Menaxhim klase” më një lëndë tjetër që lidhet ngushtë me menaxhimin e mjediseve të të nxënit dhe të grupeve të fëmijëve të arsimit parashkollor.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore (syllabuset), por dhe nga takimi me pedagogët e programit rezulton se programet lëndore që zhvillohen, rishikohen dhe pasurohen në vijmësi nga pedagogu përgjegjës dhe përgjegjësi i programit të studimit. Identifikuam se pedagogët mbështeten në literaturë vendase dhe të huaj për t’u ofruar studentëve një kurrikul sa më zhvilluese dhe mbështetëse. Gjatë zbatimit të syllabusit, pedagogët analizojnë pikat e forta dhe të dobëta të programit, pas të dhënave të përpunuara të pyetësorëve të studentëve që vijnë nga NJSBC. Në këtë mënyrë, secili/a pedagog/e analizon çështjet e ndryshme, të cilat janë konstatuar gjatë trajtimit si të panevojshme apo të paplotësuara dhe kompletohen duke synuar përsosjen e qëllimit të lëndës. Në departament diskutohen çështje të ndryshme për përmirësimin në vazhdimësi të procesit mësimor dhe të syllabuseve. Departamenti zbaton proceduar të aplikueshme për hartimin dhe miratimin e programeve lëndore në fillim të vitit akademik ku secili/a pedagog/se paraqet dhe risitë apo përmirësimet që ka bërë¹¹¹.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli</p>	<p>Nga analiza e programeve lëndore si dhe bisedat me stafin e programit konstatojmë se në përfundim të çdo lënde/moduli pedagogu/ia vë në dukje përmbushjen e pritshmërive/rezultateve të të nxënit, orienton vëmendjen e studentëve në pikat kyçe dhe nxit përsëritjen dhe përvetësimin e këtyre dijeve për t’i ndihmuar studentet që të brendësojnë këto dije dhe t’i zbatojnë ato në profesionin e tyre në të ardhmen. Programet lëndore paraqesin</p>

¹¹⁰ Evidencë-30 -Dosja e Plotë e programit të studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor”.

¹¹¹ Evidencë-33 - Plani Mësimor për Programin Bachelor “Arsim Parashkollor”.

<p>akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>kompetencat që synohen të formohen nga studentët në laboratorë dhe praktika profesionale dhe kërkesat e tregut të punës¹¹². Staf i gjykon se studentit i krijohet mundësia t'i zbatojë këto kompetenca gjatë orëve të leksioneve, duke u përfshirë aktivisht në to, gjatë diskutimeve në orët e seminareve, si dhe praktikës profesionale, e cila është një lëndë e veçantë që zhvillohet gjatë këtij programi.¹¹³ Mësimdhënia në këtë program studimi, kombinon formimin teorik me përvojën praktike dhe realizohet në bashkëpunim me institucione të ndryshme pranë të cilave mund të zhvillohen praktikat profesionale, të cilat zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentëve.¹¹⁴</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga diskutimi me pedagogët me kohë të plotë dhe me kohtë të pjesshme rezulton se ata zhvillojnë organizuar trajnime brenda departamentit me stafin akademik të tij, mbi “Metodat novatore në mësimdhënie”, ku stafi është njohur me metodat më të reja që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies; “Platformat teknologjike në mësimdhënie”, e cila ka patur si qëllim formimin e qëndrimeve dhe vlerave mbi rolin dhe rëndësinë e e platformave teknologjike, për të krijuar një mjedis sa më mbështetës për të nxënë të studentëve. Vitet e fundit Departamenti ka organizuar një konferencë të përvitshme kombëtare, ka organizuar trajnime mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, ku përmendim trajnime/aktivitete të dedikuara për stafin si p.sh. trajnimi mbi përdorimin e platformës Moodle në kushtet e mësimin online, orët e hapura të personalit akademik efektiv, etj.^{115/116/117}</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit III.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja ka funksionale struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies në programet e studimit. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

¹¹² Evidencë-128 - Studimi i Tregut të Punës, Departamenti i Pedagogjisë.

¹¹³ Evidencë-101-Manual i Praktikës Bachelor.

¹¹⁴ Evidencë-61.1-Ndarja e Mentorimit në Departament.

¹¹⁵ Evidencë-80-Baza e Kërkimit Shkencor në Njësinë Bazë.

¹¹⁶ Evidencë-112-Raport mbi Veprimtarinë kërkimore-shkencore të departamentit.

¹¹⁷ Evidencë-69-Lista e Leksioneve të Hapura 2021-2022.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit, por dhe nga takimi me stafin e programit rezulton se Departamenti i Pedagogjisë zbaton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. Rezulton se në përfundim të programit Bachelor “Arsim Parashkollor” studentët i nënshtrohen provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimit të diplomës. Në Rregulloren e programit të studimit¹¹⁸ përcaktohet pragu i notës mesatare, e cila është 8, duke i dhënë të drejtën studentëve që kanë mesataren nën 8 t’i nënshtrohen provimit dhe ata që janë mbi 8 të bëjnë punim diplome. Studentët plotësojnë formularin, në të cilin deklarojnë përmbylljen e këtij cikli me provim formimi apo mbrojtje teme diplome dhe e dorëzojnë në sekretari.¹¹⁹ ¹²⁰.Departamenti i pedagogjisë respekton rregullat konform Rregullores së Programit të studimit Bachelor “Arsim Parashkollor” ¹²¹ por dhe të Manualit të posaçëm për punimin e diplomës bachelor.¹²²</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me studentët ata shprehën se ndihmohen, janë të mbështetur dhe të lehtësuar lidhur me informacionet e domosdoshme për ta që kanë të bëjnë me përballimin e lëndëve, me literaturën, me vlerësimin e arritjeve. Sa i përket vlerësimit përfundimtar, konstatojmë se ai është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit.^{123/ 124/125}. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon</p>

¹¹⁸Evidencë-27-Formulari i Kërkesës për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi.

¹¹⁹ Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor “Arsim Parashkollor” 2019.

¹²⁰ Evidencë-3.1-Rregullore FE, 2019.

¹²¹ Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor “Arsim Parashkollor” 2019.

¹²² Evidencë-99-Manual për punimin e Diplomes Bachelor.

¹²³ Evidencë-46 -Udhëheqjet e Temave të Diplomave, Bachelor “Arsim Parashkollor” 2020-2021.

¹²⁴ Evidencë-46.1 -Udhëheqjet e Temave të Diplomave, Bachelor “Arsim Parashkollor” 2021-2022.

¹²⁵ Evidencë-46.2 -Udhëheqjet e Temave të Diplomave, Bachelor “Arsim Parashkollor” 2022-2023.

	dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit, duke firmosur tezën e diplomës. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. Konstatohet se për periudhën 2020-2023, studentët kanë finalizuar provën finale me anë të provimit ^{126/127} .
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nga takimi me stafin, me Përgjegjës të departamentit dhe Dekanin rezultojnë se Provimi i formimit/punim diplome realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik i departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga dekani. Komisioni i provimit përfundimtar përbëhet nga titullarët e lëndëve të përzgjedhura, të cilët hartojnë tezën e provimit final duke u mbështetur në literaturën dhe njohuritë që studentët kanë marrë gjatë viteve të shkollimit ^{128/129} .
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në Rregulloren e programit, por dhe në bisedat me stafin e akademik të tij konstatohet se Pedagogu udhëheqës i diplomës orienton dhe mbështet studentin për punimin e diplomës. Në këtë program studimi, këto vitet e fundit, studentët kanë zhvilluar provimin me shkrim dhe jo punim të diplomës, për arsye të zgjedhjes së tyre, por dhe për arsye të mospërbushjes së kriterit të notës mesatare nga ana e studentëve ¹³⁰ .
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga takimi me studentët konstatohet se ata lehtësohen nga IAL-ja lidhur me procese kërkimore që bazohen në matje, analiza, teste, për të cilat studentët kanë në dispozicion mjediset e Fakultetit të Edukimit për të punuar në përgatitjen e temës së diplomës, si p.sh. laboratorit të teknologjisë, biblioteka etj. Studentët shprehin se ata ndihmohen nga stafi akademik i departamentit të pedagogjisë për realizimin e detyrimeve akademike të studentëve, apo për hedhjen e

¹²⁶ Evidencë-19-Rregullore e Diplomimit 2019/ Neni 75 Rregullore UAMD.

¹²⁷ Evidencë-99-Manual për punimin e Diplomes Bachelor.

¹²⁸ Evidencë-3.1-Rregullore FE, 2019.

¹²⁹ Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

¹³⁰ Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

	të dhënave tabelare, grafike dhe të analizave statistikore, etj. që mund t'i duhet një studenti për të përgatitur temën e diplomës. ^{131/132}
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit dhe Rregullores së UAMD, si dhe nga takimet me stafin akademik evidentojmë se zbatohen procedura zyrtare për përfundimin e provës finale. Për vlerësimin e provimit të formimit në “Arsim Parashkollor” studentët vlerësohen me notë, nisur nga përgjigjet e dhëna në provimin me shkrim që ata bëjnë, duke u vlerësuar nga komisioni i ngritur. Mbrojtja e diplomës bëhet para komisionit të posaçëm të ngritur nga departamenti i pedagogjisë dhe vlerësohet me notë. Ky vlerësim i provimit të formimit apo i mbrojtjes së diplomës pasqyrohet në procesverbalet e depozituara në sekretarinë mësimore, procesverbale këto që firmosen nga gjithë anëtarët e komisionit që ka hartuar tezën (për rastin e provimit të formimit) ose anëtarët e komisionit të diplomimit (kur mbrojtja e diplomës bëhet me temë). Më pas Rezultati përfundimtar që pasqyrohet në procesverbal, bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, dhe iu komunikohet studentëve. ^{133/134}
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Nga takimet me studentë, me sekretarinë, me Drejtorinë e Kurrikulës Standardeve dhe Cilësisë rezulton se pas përfundimit të studimeve, studenti plotëson dokumentacionin e kërkuar dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës ¹³⁵ (anglisht dhe shqip), të miratuara nga MAS. Studenti mund të pajiset me programet e lëndëve në varësi të kërkesës së tij, sipas nevojës. Ky dokumentacion (diplomë dhe suplement) i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Kurrikulës, Standardeve dhe Cilësisë. U vu re se Diploma plotësohet me shkrim të qartë dhe me bojë teknike. Ajo nënshkruhet nga dekani/drejtuesi i njësisë kryesore të Fakultetit të Edukimit dhe nga Rektori i UAMD. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada shkencore dhe titulli akademik. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e UAMD. Sipas Statutit të IAL-së, për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet Çertifikata “Medalje e Artë” dhe për studentët që gjatë studimeve, kanë marrë mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesën tjetër vetëm 9 (nënta), jepet Çertifikata “Student i Shkëlqyer”. ^{136/137/138}

¹³¹ Evidencë-3.1-Rregullore FE, 2019.

¹³² Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

¹³³ Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

¹³⁴ Evidencë-3.1-Rregullore FE, 2019.

¹³⁵ Evidencë-39 -Suplementi i Diplomës Bachelor "Arsim Parashkollor".

¹³⁶ Evidencë-1-Statuti UAMD, 2018.

¹³⁷ Evidencë-3.1-Rregullore FE, 2019.

¹³⁸ Evidencë-3.1.1.2 Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore, nga bisedat me Përgjegjësen e Departamentit, si dhe me studentë konstatojmë së institucioni ruan gjatë viteve të studimit kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen, ku respektohen të drejtat e privatësisë. Studentët shprehen se ata, në mbyllje të studimit, kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal¹³⁹. Këto të dhëna janë të regjistruara dhe të ruajtura pranë sekretarive mësimore përkatëse, që përbën regjistrin themeltar. Po ashtu u konstatua se UAMD-ja ka në funksion të plotë që nga viti 2013 sistemin e menaxhimit të studentëve “Pitagora”, i cili ruan informacionin dhe në formë elektronike. Po ashtu tema e diplomës bëhet nga studentët në tri kopje, nga të cilat një kopje ruhet në departament në hard copy dhe elektronikisht (CD), një kopje ruhet në sekretarinë mësimore dhe një kopje në bibliotekën¹⁴⁰ e Fakultetit të Edukimit. Sekretaria mësimore disponon një regjistër bazë të studentëve me të dhëna. Ky regjistër, në formë të shkruar dhe elektronike, pasqyrore vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhënat për diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj. Të dhënat bazë i dërgohen Qendrës së Shërbimeve Arsimore.^{141/142}</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit III.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja zbaton procedura zyrtare sa i takon detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

¹³⁹ Evidencë-127-Rregullorja për Arshivën e Dokumentacionit.

¹⁴⁰ Evidencë-85 -Rregullore e Bibliotekës <https://uamd.edu.al/bibliotekauniversitare/>.

¹⁴¹ Evidencë-3.1-Rregullore FE, 2019.

¹⁴² Evidencë-3.1.1.2Rregullore e Programit të studimit Bachelor "Arsim Parashkollor" 2019.

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR
REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik me kohet të plotë dhe me kohë të pjesshme në dispozicion të programit të studimit Bachelor “Arsimi Parashkollor” që mbulon Departamenti i Pedagogjisë janë pjesë e marrëveshjes së bërë mes departamenteve të tjera të fakultetit si me Departamentin e Psikologjisë Sociologjisë, Gjuhës, Informatikës dhe Gjuhëve të huaja, përmbushin kërkesat ligjore dhe janë të kualifikuar.¹⁴³</p> <p>Stafi akademik për këtë program janë 2022-2023 11 PAE/2 PAK 2021-2022 10PAE /5 PAK 2020-2021 11 PAE/4 PAK ¹⁴⁴</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve që mbulojnë dhe fushave të studimit rezulton se të gjithë titullarët e lëndëve që mbulojnë këtë program studimi, kanë nivelin e duhur të kualifikimit dhe fushat kërkimore të tyre përputhet me programin. ^{145/ /146/ 147.}</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i të dhënave mbi personelin akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në “Arsimi Parashkollor” rezulton se stafi akademik efektiv dhe ai nga departamentet e tjera është në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, date 10.09.2018 “Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe rregullores së UAMD-së (neni 102,103,104 rregullores).^{148, 149}</p> <p>Rezulton se stafi akademik PAE mbulon mbi 87% të ngarkesës mësimore të këtij programi studimi.¹⁵⁰</p>

¹⁴³ Procedurat e rekrutimit të stafit akademik në departamentin e Pedagogjisë. (Ref.Evidenca 115)

¹⁴⁴ Të dhëna për kualifikimin për stafin akademik në programin Bachelor “Arsimin Parashkollor” (Ref.Evidenca 120)

¹⁴⁵ Fusha e studimit për stafin akademik përgjegjës për programin Bachelor AP në Departamentin e Pedagogjisë. (Ref. Evidenca Nr. 129)

¹⁴⁶ CV e stafit akademik c Fakultetit të edukimit të UAMD (Ref. Evidenca në D osjen dorëzuar në Ascal.)

¹⁴⁷ Të dhëna tabelore për personelin akademik për programin Bachelor “Arsimi Parashkollor” (Ref. Evidenca Nr 120)

¹⁴⁸ Udhëzimin Nr. 29, date 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të lartë

¹⁴⁹ Rregullore e UAMD-së (Ref. Evidenca Nr. 3)

¹⁵⁰ Të dhëna tabelore për stafin akademik në programin Bachelor “Arsimi Parashkollor” (Ref.evidenca nr. 64.1)

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga analiza e planeve mësimor në tabelat e paraqitura lidhur me pedagogët që japin mësim në programin e studimit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" konstatohet se stafi akademik që mbulon ngarkesën e këtij programi sipas lëndëve është në përgjithësi i pandryshueshëm dhe i janë likuiduar detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Në zyrën e burimeve njerëzore për të gjithë stafin si PAE ashtu dhe PAK kishte kontrata dhe paguheshin sigurimet shoqërore. Gjatë pesë viteve të fundit të funksionimit të këtij program studimi 2018-19 deri në vitin 2022-2023 ka një qëndrueshmëri të personelit që mbulojnë lëndët mësimore të këtij programi¹⁵¹</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në Rregulloren dhe Statutin e institucionit UAMD si dhe dokumentacionit që disponon Departamenti i Pedagogjisë dhe Burimet njerëzore rezultojnë se janë të përcaktuara kriteret e përgjithshme dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe atij më kohë të pjesshme.¹⁵²</p> <p>Bazuar në rregulloren e UAMD-së (neni 103,104,105) dhe Fakultetit të Edukimit(neni 25, 26) Departamenti mund të vendosë kritere specifike në përshtatje me kërkesat që ka për pedagogun që do të rekrutojë, kritere që miratohen më pas nga Rektori¹⁵³</p> <p>Në takimin me njësinë e Burimeve njerëzore u konstatua se në rekrutimin e stafit të ri ndiqen të gjitha procedurat e përcaktuara në rregullore, duke filluar nga përcaktimi i kritereve të përgjithshme dhe specifike, shpallja në APP, ngritja e komisionit të vlerësimit, shqyrtimi i dosjes dhe intervista, të gjitha transparente publikuar në faqen zyrtare¹⁵⁴</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës</p>	<p>Në raport flitet për mjedise bashkohore që ka institucioni dhe Fakulteti i Edukimit për të siguruar një mësimdhënie sa më cilësore, laboratore të tilla si laborator i multimedias, por nuk rezultojnë se ka laboratore apo mjedise mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit, dhe nuk jepen të dhëna për personelin ndihmës akademik.^{155, 156} Në takimin me stafin u theksua se pavarësisht mungesës së ambienteve specifike për programin, pedagogët improvizojnë këto ambiente në mjedise ku jepen mesim.</p>

¹⁵¹ Ngarkesa e stafit akademik me kohe te plotë në Bachelor " Arsimi Parashkollor" (Ref.Evidenca Nr.52)

¹⁵² Procedurat dhe formularë te përdorur për rekrutimin e personelit ne UAMD (Ref.Evidenca Nr. 115)

¹⁵³ Rregullore e Fakultetit të Edukimit në UAMD (Ref.Evidenca Nr. 3.1)

¹⁵⁴ Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al> (Mundesi punesimi)

¹⁵⁵ Kapacitetet e UAMD FE, (Ref.Evidenca Nr. 55)

¹⁵⁶ Manual i përdorimit te sistemit Pitagora. (Ref.Evidenca Nr. 93-94)

specifike të programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Gjatë vizitës dhe takimeve me drejtues të Departamentit të Pedagogjisë dhe Degës së Burimeve njerëzore bazuar në verifikimin e dosjeve të personelit akademik dhe jo akademik konfirmojmë që ekziston një bazë të dhënash të detajuara për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, titujt dhe gradat shkencore që kanë ngarkesë mësimore në kuadrin e këtij programi, kualifikimin, punën shkencore të tyre, ^{157, 158} Të gjitha strukturat përgjegjëse të programit të studimit Bachelor në “Arsimi Parashkollor” të UAMD Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Sekretaria Mësimore, bazuar në rregulloren e programit të studimit disponojnë listën e plotë të personelit akademik që jep mësim në këtë program për çdo vit akademik dhe kanë informacion të plotë për realizimin e programit dhe periudhën kohore të realizimit të detyrave përkatëse. ^{159 160}
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UAMD dhe Fakulteti i Edukimit rezulton se ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me DRAP Durrës për realizimin e praktikave profesionale të studentëve të programit të si dhe me institucione të tjera të arsimit parashkollor. ¹⁶¹ Njësia kryesore Fakulteti i Edukimit ka edhe një rregullore të praktikës profesionale ku pasqyrohet qellimi objektivat dhe mënyra e vlerësimit të studentëve. ¹⁶² Në rregulloren e studimit të Fakultetit të Edukimit (neni 73;74;75,) janë të përcaktuara qartë detyrat e strukturave dhe personelit akademik lidhur me detyrimet mbyllëse të studentëve që ndjekin këtë program studimi ¹⁶³ .
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e bëra gjatë vizitës konfirmojmë se Fakulteti i Edukimit i ka të sanksionuara në

¹⁵⁷ Titujt dhe gradat shkencore të stafit të programit të studimit Bachelor “Arsimi Parashkollor” (Ref. Evidenca Nr. 120)

¹⁵⁸ Te dhëna tabelore për personelin akademik të programit Bachelor “Arsimi Parashkollor”(Ref.Evidenca Nr.44.1.2.3)

¹⁵⁹ Ngarkesa e stafit akademik me kohe të plotë në Bachelor “Arsimi Parashkollor” (Ref.Evidenca Nr.52)

¹⁶⁰ Numri i stafit akademik në programin Bachelor Arsimi Parashkollor (Ref.Evidenca Nr. 50)

¹⁶¹ Marrëveshje bashkëpunimi mes Fakultetit të Edukimit dhe DRAP Durrës për organizimin e praktikave profesionale të bachelor Arsimi Parashkollor (Ref.Evidenca Nr. 67, 53)

¹⁶² Rregullore e praktikës profesionale të studentëve (Ref.Evidenca Nr.102.)

¹⁶³ Rregullore e Fakultetit të Edukimit në UAMD (Ref.Evidenca Nr. 3.1)

<p>pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>marrëveshjet e lidhura me institucionet pritëse për praktikën mësimore dhe ka përcaktuar qartë detyrimet e personelit mbikqyrës lidhur me studentët, gjatë kohës së praktikës si dhe me plotësimin e raportit përfundimtar dhe formularit të vlerësimit që i dërgohet.¹⁶⁴</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mendon se Fakulteti i Edukimit dhe në veçanti Departamenti i Pedagogjisë që mbulon këtë program studimi ka personel akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë, i cili përmbush standardet ligjore dhe akademike në përputhje me fushën e programit. Standardi përmbushet plotësisht</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Arsimin Parashkollor” ka një infrastrukturë të mjaftueshme që përfshin ambiente për Leksione dhe Seminare pranë korpusit të ri në Spitalë, që i plotësojnë kriteret, dhe sigurojnë një mësim normal të këtij programi studimi, bazuar edhe në numrin në ulje të studentëve në këtë program studimi. Janë 15 auditore me kapacitet 1141 vënde. Në dispozicion është edhe një sallë konferencash me kapacitet 218 vënde për organizimin e konferencave të ndryshme. Staf i akademik si edhe ai administrativ është i sistemuar në 16 zyra në të cilat janë instaluar pajisjet e nevojshme për një funksionim normal të punës. Për vetë natyrën specifike të këtij programi është në dispozicion të këtij programi edhe një laborator me kapacitet 64 vënde.¹⁶⁵</p>

¹⁶⁴ Formular vlerësimi I studentëve në praktikën profesionale (Ref.Evidenca Nr.100)

¹⁶⁵ Dokumentacion mbi asetet objektet pasurite dhe politikat e prones në UAMD (Ref.Evidenca Nr.55)




<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit të UAMD në ambientet në funksion të programit të studimit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" kishte mjedise mësimore si auditore, salla mësimi të paisura me mjete elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit, në mënyrë të vecantë të teknologjisë bashkohore ne fushën e mësimdhënies.^{166, 167}</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit në UAMD ka mjedise të mjaftueshme dhe të paisura me aparatura dhe mjetet e nevojshme didaktike dhe teknologjike të cilat janë në dispozicion të programit të studimit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" në përputhje me kërkesat e lëndëve për një formim teorik dhe praktik të studentëve, përcaktuar në qëllimet e programit.¹⁶⁸</p> <p>Rezulton se nuk ka ambiente apo atelie për lëndët vizatim muzikë dramatizim, etj. <i>Mendojmë se për një formim profesional më të mirë të studentëve për arsimin parashkollor, departamenti duhet të krijojë mjedise specifike për edukimin figurativ dhe atë muzikor apo edhe për dramatizimin.</i></p> <p><i>Rekomandojmë që fakulteti që mbulon këtë program sudimi të krijojë apo përshtasë mjedise mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit si për vizatim, pune dore ashtu edhe për teatrin me kukulla.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit, në korpusin e ri ka në funksion të programit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" edhe një laborator të informatikës i paisur me kompjutera, laptop, smart bord, projektore etj, paisur nga projekti TEAVET, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë të mësimdhënies e mësimnxënies si dhe për aftësimin teorik dhe praktik në përputhje me objektivat e programit. Në programet profesionale që na u prezantuan për programin e studimit bachelor në arsimin parashkollor, ishin programi SPSS, por jo programe të tjera.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ arrin në konkluzionin se institucioni ka mjaftueshëm mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin</i></p>

¹⁶⁶ Të dhena mbi kapacitetet e godinës së Fakultetit të shkencave të Edukimit (Ref.Evidenca Nr. 55)

¹⁶⁷ Vizita në kampus dhe faqja zyrtare e UAMD.

¹⁶⁸ Të dhena mbi kapacitetet e godinës së Fakultetit të shkencave të Edukimit (Ref.Evidenca Nr. 55)

	<i>teorik dhe praktik sipas objektivave formuese të programit të studimit, por duhet të mendojë edhe për mjedise specifike që kërkon natyra e këtij program studimi. Standardi përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Sipas formatit të programeve lëndore të programit të studimit Bachelor në “Arsimin Parashkollor” janë përcaktuar si elementë edhe literatura bazë dhe e rekomanduar që u ofrohet studentëve qoftë fizike ashtu edhe digjitale (literaturë e cila gjindet ne bibliotekën e UAMD fizikisht dhe online U LIBRARY) e cila siguron marrjen e njohurive të domosdoshme për një formim profesional të studentëve. Departamenti i Pedagogjisë si edhe departamentet e tjera ka nje metodologji të përzgjedhjes së teksteve mësimorë, ¹⁶⁹ <i>Literatura që i ofrohet studentëve në syllabuset e paraqitura në përgjithësi e përmbush udhëzimin e MAS -së përsa i përket përditësimit të saj me botime të viteve të fundit, por në disa syllabuse ka vend për përmirësim.¹⁷⁰</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Fakulteti i Edukimit si edhe konstatohet nga vizita në institucion bën një përpjekje të vazhdueshme për përditësimin e literaturës me botime të reja nepërmjet përcaktimit të një fondi për bibliotekën, bazuar në kërkesat e Departamentit të Pedagogjisë. Nga ana tjetër edhe biblioteka ka një plan strategjik ku përfshihet edhe detyrimi i pedagogëve për të zgjeruar fondin e saj me çdo botim të tyre të ri. ¹⁷¹
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Biblioteka pranë Fakultetit të Edukimit në korpusin e ri të UAMD ka nje kapacitet 120 vende,dhe ka një bashkëpunim të mirë si me bibliotekat universitare si në vend duke qënë pjesë e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëri dhe me institutin UNRISD në Zvicër.

¹⁶⁹ Informacion per biblioteken online (Ref.Evidenca Nr 86-89)

¹⁷⁰ Syllabuset e lëndëve të programit Bachelor “ Arsimi Parashkollor”.(Ref. Evidenca syllabuset MP API pdf)

¹⁷¹ Relacion për veprimtarinë e bibliotekës (Ref.Evidenca Nr. 87)

barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka garanton një shërbim të barabartë për të gjithë studentët e programe të ndryshme studimi, dhe në këtë aspekt edhe programit Bachelor në “Arsim Parashkollor” që mbulon ky fakultet. Studentët kanë akses në shërbimet online (Katalogun online të integruar) dhe Arkivën digjitale që ka shtuar larminë e burimeve për materiale e literaturë në fusha të ndryshme të studimit. ¹⁷²
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita në bibliotekën e FE, si dhe nga verifikimi i fondit të librave që disponon kjo bibliotekë rezulton se në dispozicion të programit të studimit Bachelor në “Arsimin Parashkollor” është një fond i mjaftueshëm librash në shqip dhe në gjuhë të huaja, dhe që janë në përputhje me literaturën bazë dhe të rekomanduar të programeve të lëndëve, moduleve dhe veprimtarive mësimore të programuara në to. Biblioteka i jep mundësinë studentëve të shfrytëzojnë edhe fondin periodik, gazeta revista si dhe përdorimin e librarisë elektronike. ¹⁷³
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga vizita në ambientet e Bibliotekës konstatohet se janë krijuar kushte dhe ka akses të barabartë për studentët për shfrytëzimin e ambienteve dhe fondit të saj, nëpërmjet rregjistrimit falas dhe mundësisë së përdorimit të bibliotekës online ku studentët marrin informacion si nga literatura shqipe dhe e huaj. ¹⁷⁴ Studentët kanë akses edhe në U-Library duke u ofruar atyre edhe një manual përdorimi të saj. ¹⁷⁵
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita në ambientet e bibliotekës së FE rezulton se ka ambiente fizike të mjaftueshme dhe është mirë e paisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera në shërbim të studentëve. Biblioteka ka të instaluar “Katalogun online” me sistemin “Koha” “Pa kosto” që mundëson studentëve marrje informacioni edhe jashtë ambienteve të institucionit. ¹⁷⁶
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me	Në faqen zyrtare të UAMD dhe në ambientet e bibliotekës së FE - së e përcaktuar edhe në rregulloren e saj janë të verifikueshme oraret e bibliotekës cila qëndron e hapur cdo ditë nga ora 8.00 deri 16.00, dhe për informacionin elektronik ora 8.00 deri 20.00 ¹⁷⁷

¹⁷² Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al> Rubrika Studentët ,Biblioteka studentore.

¹⁷³ Të dhëna për bibliotekën UAMD (Ref.Evidenca Nr.86- 89)

¹⁷⁴ Rregullore e bibliotekës UAMD (Ref.Evidenca Nr. 85)

¹⁷⁵ Manual Përdorimi biblioteka online (Ref.Evidenca Nr 86)

¹⁷⁶ Rregullore e bibliotekës UAMD (Ref.Evidenca Nr. 85)

¹⁷⁷ Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al> (Biblioteka studentore)

<p>oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Në situata të vecanta provimesh kjo bibliotekë shërben me ditë dhe orare të përshtatshme për studentët.¹⁷⁸</p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka studentore e FE rezulton se ka një bashkëpunim të mirë mes strukturave të institucionit për të garantuar cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës si dhe përditësimin e këtij fondi si dhe nivelin e shfrytëzimit të tij.</p> <p>Biblioteka punonte sipas standarteve ndërkombëtare dhe udhëzimeve të përcaktuara nga IFLA (Federata Ndërkombëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Bibliotekave) dhe ka procedura të përcaktuara bashkëpunimi me strukturat e tjera të UAMD për pasurimin e fondit të saj.^{179 180}</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për të vënë në dispozicion si literaturë bashkohore për studentët por edhe një mjedis pune në bibliotekë e cila ka siguruar një fond të mjaftueshem librash si fizik dhe në rrugë dixhitale. Mendojmë se përditësimi i literaturës sidomos asaj të rekomanduar në programet lëndore/syllabuset duhet të jetë i pranishëm në të gjitha programet lëndore/syllabuset. Standardi përmbushet plotësisht</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

¹⁷⁸ Kalendari i funksionimit të bibliotekës në fundjavë. (Ref.Evidenca Nr. 88)

¹⁷⁹ Të dhena për bibliotekën UAMD (Ref.Evidenca Nr 86- 89)

¹⁸⁰ Relacion për bibliotekës (Ref.Evidenca Nr. 87)

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Nepërmjet një sistemi të menaxhimit UAMD dhe Fakulteti i Edukimit si njësi përbërëse e saj, administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Ky sistem përfshin Departamentet, Sekretariatë mësimore, Sistemi PITAGORA, Drejtoria e Administrimit dhe Sherbimeve akademike, sektori i IT që ofron një sasi aplikacionesh të integruara me njëra tjetrën e cila jep mbështetje të plotë për procedurat e administrimit të dokumentacionit të studentëve nga regjistrimi e deri në diplomimin e tyre^{181 182 183}</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në Fakultetin e Edukimit si dhe strukturat e tjera ndihmëse si Njesisë të Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Drejtoria e Administrimit dhe Sherbimeve akademike, Sekretarive mësimore rezultojnë të ketë një sistem menaxhimi të informacionit, bazuar në një rregullore për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit, ku administrohet tërë dokumentacioni që lidhet me përditesimin e të dhënave të stafit akademik ndihmës akademik dhe administrativ lidhur me tërë veprimtarinë e tyre në kuadrin e realizimit të programit të studimit Bachelor "Arsim Parauniversitar."^{184 185}</p> <p>Sistemi i menaxhimit pranë FE si pjesë e veprimtarisë të sistemit të UAMD-së publikon të dhëna që janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të UAMD dhe të njësive përkatese. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të UAMD dhe Fakultetit të Edukimit, ku ofrohet programi i studimit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" siguron të akses të informacioneve dhe e dokumentave. Sektori i çështjeve mësimore vë në dispozicion të studentëve si planin mësimor, syllabeset, të dhëna të tjera kur kërkohen kopje fizike e tyre^{186 187}</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm të UAMD dhe Fakultetit të Edukimit, ku ofrohet programi i studimit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Një platformë e tillë</p>

¹⁸¹ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> (Sherbime, Pitagora, Sekretaria mesimore)

¹⁸² Udhëzues i karrierës " (Ref. Evidenca Nr.21)

¹⁸³ Relacion per aktivitetin e bibliotekes (Ref.Evidenca Nr.87)

¹⁸⁴ Rregullore e sekretarise mesimore (Ref.Evidenca Nr. 138)

¹⁸⁵ Të dhëna tabelore për personelin akademik ne Departamentin e Pedagogjise (Ref.Evidenca Nr. 44.1.2.)

¹⁸⁶ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> (Sherbime, Pitagora, Sekretaria mesimore)

¹⁸⁷ Rregullore e sekretarise mesimore (Ref.Evidenca Nr. 138)

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	<p>është Platforma Pitagora, që jep mundësi komunikimi të pedagogeve me studentë për aspekte të tilla të procesit mësimor si: të dhëna për frekuentimin, analizë të esseve të studentëve dhe detyrave të kursit,notat e provimeve, oraret për takime apo konsultime.¹⁸⁸</p> <p>Një mundësi komunikimi është edhe ëeb.i universitetit,rrjetet sociale si dhe përdorimi i platformave Moodle ; Classroom team; Zoom etj¹⁸⁹</p>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<p>Departamenti i Pedagogjisë GVB i njësisë në vijimësinë e punës organizojnë vazhdimisht monitorime që lidhen me aktivitetin akademik dhe administrativ. Mbi bazën e informacionit të mbledhur herë pas here bëhen përpjekje për vlerësimin e aktivitetit mësimor dhe shkencor të stafit, dhe materiali i vihet në dispozicion Drejtuesit të fakultetit.^{190 191}</p>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>Nga verifikimi në Faqen zyrtare të UAMD-së mund të konfirmojmë se institucioni publikon vazhdimisht informacione për të gjitha fushat e funksionimit në Universtitetit dhe në këtë kuadër edhe të informacionit që lidhet me programin e studimit Bachelor në" Arsimin Parashkollor". Në këtë faqe zyrtare ka të dhëna për departamentin pedagogët, studentët, urdhera dhe udhëzime,veprimtari si dhe informacion që lidhet më programin e studimit ¹⁹²</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ mendon se FE si pjesë e strukturave të UAMD ka një sistem menaxhimi institucional që bën përpjekje për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ të institucionit që lidhet me programin e studimit. Standardi permbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

¹⁸⁸ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> (Sherbime,Pitagora)

¹⁸⁹ Manual i perdorimit te sistemit pitagora(Ref.Evidenca_Nr 93).

¹⁹⁰ Rregullore per funksionimin dhe organizimin e sigurimit te cilesise Nr13)

¹⁹¹ Raporti i analizës se anketimit të studentëve ,Stafi akademik,administrata (Ref.Evidenca Nr.14)

¹⁹² Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al>

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UAMD harton çdo muaj nepërmjet Drejtorisë së Financave një raport financiar për shpenzimet dhe të ardhurat lidhur me veprimtarinë akademike dhe shkencore të institucionit, duke përfshirë këtu zera që lidhen me shpenzimet për programet e studimit që ajo ofron.¹⁹³</p> <p>Nuk rezulton që Departamenti i Pedagogjisë të ketë hartuar një projekt raport financiar lidhur me kostot e programit të studimit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" të cilin duhej të ja paraqiste Dekanit të fakultetit, dhe Drejtorisë së financave. Evidencat 130; 131 dhe 134 të paraqitura në RVB nuk janë dorëzuar edhe pas kërkesës tonë.</p> <p><i>Rekomandojmë që njësia bazë të hartojë një plan financiar për mbështetjen financiare të programeve që mbulon për të garantuar vazhdimësinë normale të tyre.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të</p>	<p>UAMD nepërmjet Drejtorisë së financave ka një plan financimi për tërë strukturat universitare i cili miratohet në Senatën akademik të institucionit dhe në Bordin e Administrimit.¹⁹⁴</p> <p>Rezulton nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikuar në vizitën në UAMD se plani i financimit të programit të studimit Bachelor Arsimi Parashkollor i ofruar nga Departamenti i Pedagogjisë si edhe raportohet në RVB (Evidenca 131) nuk është paraqitur.</p> <p>Nga shqyrtimi i buxhetit të institucionit konstatohet se është planifikuar sipas zerave të caktuar në buxhet, mbulimi i kostove për personelin PAE dhe PAK, mirëmbajtje e mjediseve, si dhe shpenzime për bibliotekën online.¹⁹⁵</p>

¹⁹³ Tabela financiare për të ardhurat dhe shpenzimet mujore dhe progresive. (Ref. Faqes zyrtare <https://uamd.edu.al> Rubrika Transparenca, Informacion mbi buxhetin)

¹⁹⁴ Tabela financiare për të ardhurat dhe shpenzimet mujore dhe progresive. (Ref. Faqes zyrtare <https://uamd.edu.al> Rubrika Transparenca, Informacion mbi buxhetin) (Raporti financiar 2021-22 Evidenca 111)

¹⁹⁵ Raport i veprimtarisë ekonomiko-financiare të UAMD (Ref. Evidenca Nr.111)




studimit, projektet dhe zëra të tjerë.									
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar në VKM nr 83, date 03.02.2016, auditimit të brendshëm në Sektorin publik, UAMD ka njësi auditimi Drejtorinë e auditimit, por nuk rezulton se ka ndonjë raport auditimi për institucionin. Evidenca 111 e paraqitur është Raport i Veprimtarisë Financiare të UAMD per vitin 2021-22.								
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Konfirmojmë se UAMD bazuar në Udhëzimin Nr. 5, date 19.02.2018 “Per përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” paraqet pranë Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit çdo vit sipas afatit të përcaktuar, raportin për realizimin e buxhetit të vitit sipas zërave përkatës ku përfshihen edhe shpenzimet për mbulimin e programeve të studimit. Ky rapor i dergohet edhe MAS dhe i bëhet i njohur tërë njësisë të institucionit ¹⁹⁶								
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Drejtorinë ekonomike dhe takimi me drejtues të institucionit konfirmojmë se UAMD garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë Departamentit të Pedagogjisë dhe ka kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, bazuar në grandin që vjen nga buxheti i shteti, të ardhurat që realizohen nga shërbimet që kryen si dhe të ardhurat që vinë nga projektet ^{197 198}								
Konkluzione	<i>GVJ mendon se pavarësisht mangësive të konstatuara në RVB paraqitur UAMD garanton financimin dhe mbeshtetjen financiare të nevojshme për realizimin e programit të studimit, reflektuar kjo në gjendjen financiare të institucionit referuar raporteve financiar vjetore. Standardi përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

¹⁹⁶ Raport i veprimtarisë ekonomiko -financiare të UAMD (Ref. Evidenca Nr.111)

¹⁹⁷ Raport i Veprimtarisë Ekonomiko-Financiare UAMD, 2021-2022. (Ref.Evidenca_Nr111.)

¹⁹⁸ Tabela financiare për të ardhurat dhe shpenzimet mujore dhe progresive. (Ref. Faqes zyrtare <https://.uamd.edu.al>)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në rregulloren e UAMD dhe të Fakultetit të Edukimit (neni 44; 45; 67 73; 74; 75) rezulton se janë përcaktuar konform legjislacionit në fuqi dhe akteve të saja rregullatore një sërë procedurash që lidhen me mbulimin e studentëve nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve. ^{199 200} Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe nga takimi me studentë, rezulton se studentët njihen që fillim me kriteret e pranimit dhe të konkurimit nepërmjet publikimit në faqen zyrtare nga ana e institucionit, me planin mësimor dhe kërkesat e programeve të lëndëve, mënyrën e komunikimit dhe të ankimit, përparimit të tyre etj. ^{201 202}
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	UAMD dhe Fakulteti i Edukimit ndjek procedura transparente për pranimet në ciklin e parë të studimeve Bachelor në "Arsimin Parashkollor" duke filluar me propozimin e njësisë bazë, miratimin në Senatin akademik dhe MAS të kriterëve dhe kuotave (duke parashikuar kuota për kandidatë të vecantë, nga trojet, pakicat kombëtare, përsosja me aftësi të vecantë, duke i publikon në faqen zyrtare të institucionit). Këto procedura garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit. ²⁰³
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta	Fakulteti i Edukimit bazuar në propozimin e njësisë bazë Departamentit të Pedagogjisë harton dhe dergon për miratim në Senatin akademik çdo vit kriteret e veçanta për përzgjedhjen e

¹⁹⁹ Rregullore e UAMD. (Ref.Evidenca_Nr.3)

²⁰⁰ Rregullore e Fakultetit të Edukimit (Ref. Evidenca_Nr.3.1)

²⁰¹ Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al> (Studentët, kriteret e pranimit)

²⁰² Kriteret e pranimit të studentëve Fakulteti i Edukimit (Ref. Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al>)

²⁰³ Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në të gjitha programet e studimit (Ref. Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al>)

<p>për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>kandidatëve. Pas miratimit të këtyre kriterëve nga MAS ato publikohen në faqen zyrtare të UAMD.^{204 205}</p> <p><i>Në RVB e programit ky është kriteri 4.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit për gjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Rezulton se Fakulteti i Edukimit si njësi përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" në rregulloren e studimit (nenet 44 deri 46 dhe 56 deri 65.) ka miratuar dhe i ka të aksesueshme pranë sekretarive mësimore në formë shkresore dhe elektronike, procedurat e pranimit dhe konkurimit, si dhe informacion për njohjen dhe mënyrat e vlerësimit, transferimit apo ekuivalentimit të studimeve të mëparshme.²⁰⁶</p> <p>Nepërmjet Platformës Pitagora studentët njihen online për përparimin e tyre në kohë reale.²⁰⁷</p> <p><i>Në RVB ky është kriteri 3</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit rezulton se cdo vit akademik i bën të ditura studentëve të nivelit bachelor dhe palëve të tjera të interesuara kriteret e pranimit të përgjithshme dhe të veçanta, informacion mbi organizimin dhe përmbajtjen e Bachelor në "Arsim Parashkollor". Kjo realizohet nepërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit, rrjetet sociale të institucionit, faqes shtetërore dhe portalit U-Albania si dhe fletë palosjeve dhe javës së informimit.^{208 209}</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të</p>	<p>Nga dokumentacioni rezulton se UAMD harton çdo vit akademik kriteret për pranimet në ciklin e parë të studimeve Bachelor në "Arsimin Parashkollor" duke filluar me propozimin e njësisë bazë, miratimin në Senatit akademik dhe MAS të kriterëve dhe kuotave për kandidatë me aftësi të veçantë, pakicave dhe shtresave të</p>

²⁰⁴ Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al> (Studentët, kriteret e pranimit)

²⁰⁵ Vendim Senati Akademik për kriteret e pranimit të studentëve në nivelin e parë dhe të dytë të studimeve . (Ref. Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al>)

²⁰⁶ Rregullore e FE" (Ref.Evidenca 3.1.)

²⁰⁷ Manuali i përdorimit të sistemit Pitagora-RASH, Manuale për sekretarinë, pedagogun, studentin. (Ref. Faqe zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al>)

²⁰⁸ Informacion dhe shërbime dedikuar studentëve të UAMD përmes faqes zyrtare). <https://uamd.edu.al/studentet/>

²⁰⁹ Përshkrimi në Javën e informimit të programit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" (Ref.Evidenca Nr.24)

pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	margjinalizuara, duke i bërë publike në faqen zyrtare të institucionit. ²¹⁰			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në rregulloren e FE neni 45 pika 5.c konfirmohet se në konkurim mund të marrin pjesë të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor, dhe për studentët jashtë vendit pas ekuivalentimit të diplomës. ²¹¹			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në faqen zyrtare të UAMD në rubrikën Studentët, Bursa, Departamenti i Pedagogjisë publikon të dhëna për kriteret dhe mënyrën e aplikimit nga studentët për përfitim për bursa studimi si dhe për përjashtimin nga tarifa shkollore për ti ardhur në ndihmë studentëve që vinë nga shtresat në nevojë. Në takimin me studentë dhe në sekretarinë mësimore u konfirmua ky fakt. ²¹² <i>Në RVB ky kriter mungon</i>			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit si dhe harton edhe politika ndihmëse për shtresat në nevojë. Konstatohet se Formati i përdorur në RVB në standardin V.1 kriteret (kriteri 3;4;8,) nuk përputhet me formatin që ne kemi bërë vlerësimin. Standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e	UAMD ka një strukturë efektive dhe vë në dispozicion të studentëve të programit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" një informacion të vazhdueshëm lidhur me kërkesat dhe procedurat për vlerësimin dhe

²¹⁰ Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në të gjitha programet e studimit V.A. 2021-2022. (Ref.Evidenca . Nr.60)

²¹¹ Rregullore e FE. (Ref.Evidenca Nr. 3.1)

²¹² Ref. Faqe zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al> Rubrika Studentët (Bursa)

procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Kjo është sanksionuar në rregulloren e programit (në nenet 17; 19; 22 deri 32). ²¹³ Informimi i studentëve bëhet edhe nga Sekretaria mësimore, nga syllabuset e planit mësimor, guida e studentëve, koordinatori i programit dhe nga platforma Pitagora që janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit. ²¹⁴
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UAMD ka një sistem informimi të studentëve nepërmjet publikimit të Rregullores të studimit (neni 56) si dhe nga Sekretaria mësimore, e Sektori i çeshtjeve mësimore lidhur me njohjen e kualifikimeve të mëparshme. ²¹⁵ Në këtë rast ngrihet një komision ad-hoc që vlerëson numrin e krediteve që mund ti njihen studentit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	UAMD dhe FE përgjegjëse për programin e studimit Bachelor "Arsimi Parashkollor" ka ngritur një sistem informimi për studentëve që mundëson ato të njihen që në ditën e pare të mësimit në lëndët që përmban kurrikula si me përmbajtjen ashtu edhe me kriteret e vlerësimit të cilat janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve, dhe në rregulloren e studimit të këtij programi (neni 17 deri 22). ²¹⁶ Në takimin me studentë u konfirmua se ato merrnin informacion mbi vlerësimin e tyre nga sistemi Pitagora dhe nga Google classroom.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e FE (neni 73-deri deri 77) janë përcaktuar të gjitha procedurat lidhur me ecurinë e përgatitjes së diplomës si pjesën që lidhet me provimin përfundimtar ashtu edhe me përgatitjen e mikrotezës. ²¹⁷ Në raportin e paraqitur flitet për takime mes pedagogeve dhe studentëve në përgjithësi ²¹⁸ <i>përmenden neni 2; 3; 5, të rregullores së diplomimit por nuk ka një evidencë të tillë që është paraqitur.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të	Në faqen zyrtare të UAMD në rubrikën Studentët -Alumni jepet një informacion i plotë lidhur me programin e studimit, kriteret dhe procedurat e rregjistrimit. Po kështu institucioni publikon Guidën studentore' rrjetet sociale dhe javën e informimit ku jepet informacion i plotë lidhur me këtë program. ²¹⁹

²¹³ Rregullore e Bachelor në " Arsimin Parashkollor" (Ref.Evidenca pa numer ne materialet e Ascal .)

²¹⁴ Manual perdorimi te sistemit PITAGORA nga sekretaria mesimore,pedagoge dhe studente.(Ref.Evidenca Nr. 93-94)

²¹⁵ Rregullore e studimeve UAMD" (Ref.Evidenca. Nr.3)

²¹⁶ Syllabuset e lëndëve

²¹⁷ Rregullore e Fakultetit te Edukimit. ((Ref.Evidenca Nr.3.1)

²¹⁸ Formulari i takimeve pedagog - student në programin Bachelor në " Arsimin Parashkollor". (Ref.Evidenca Pjesa 1)

²¹⁹ Faqe zyrtare e UAMD .). <https://uamd.edu.al/studentet/>

interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.									
Konkluzione	<i>GVJ mendon se institucioni ka ngritur një sistem informimi të studentëve lidhur me programin e studimit që para rregjistrimit të kandidatëve dhe gjatë vitit për përmbajtjen, ecurinë e vlerësimit të tyre si dhe diplomimit, por nuk është paraqitur një manual për orientimin konkret të studentëve në procesin e diplomimit per nivelin bachelor si me provim ashtu edhe me teze diplome. (kriteri 4) Standardi permbushet kryesisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Institucioni u jep mundësi studentëve të informohen lidhur me programin e studimit strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen nepërmjet një sistemi informacioni si Rregullore e studimit të Departamentit të Pedagogjisë, Rregullores së programit Bachelor në "Arsimin Parashkollor", faqes zyrtare të institucionit etj.</p> <p>Në takimin me studentë u konfirmua se nepërmjet sektorit të çështjeve mësimore, dhe njësisive të tjera ndihmëse, pedagogëve në paraqitjen e syllabuseve ata marrin një informacion të plotë dhe të vazhdueshëm lidhur me strukturën dhe organizimin e programit të studimit.²²⁰</p> <p>Studentët shfrytëzojnë edhe faqen zyrtare dhe rrjetet sociale për të marrë informacione të përditësuara lidhur me programin.²²¹</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,	Fakulteti i Edukimit në zbatim të rregullores të UAMD ka përcaktuar përgjegjësinë e tërë strukturave të saj për informimin e studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndëve, moduleve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me programin Bachelor në "Arsim Parashkollor". Në takimin me studentë u deklarua se ato merrnin

²²⁰ Rregullore e FE. (Ref.Evidenca Nr. 3.1)

²²¹ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> Rubrika studentet

përmbytjen dhe veprimtaritë formuese.	informacion si nga pedagogët, sekretaria mësimore, si dhe nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UAMD-së ^{222 223}
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me studentë u konfirmua se ata merrnin vazhdimisht informacion nga zyra e programit të karrierës për mundësitë e punësimit të tyre dhe informacione të tjera të ndryshme. Ata konfirmuan se kishte takime dy apo tre here në vit ku jo vetëm njiheshin me tregun e punës por edhe me mënyrën e konkurimit për vend pune, orientimin në tregun e punës ashtu edhe për trainimin e tyre për përgatitjen e CV-së, leter motivimin etj., <i>por nga zyra nuk u ofrua ndonjë dokument me një axhendë dhe listë prezencë të këtyre takimeve.</i> ²²⁴ Në faqen zyrtare të UAMD në rubrikën Kariera dhe Alumni konstatohet se ka një informacion të vazhdueshëm lidhur me veprimtaritë e qëndrës. ²²⁵
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve të programit Bachelor në “Arsim Parashkollor” një sistem menaxhimi efektiv (Sekretari mësimore; Zyra e kurrikulave; Grupet e lëndëve; Takimet informuese në fillim viti shkollor; Faqja zyrtare e institucionit) për të mundësuar studenteve një informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me programin. ^{226 227} Gjatë vizitës u konstatua se institucioni ka vënë në dispozicion të programit një infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e tij.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga vizita në institucion konfirmohet se institucioni UAMD ka krijuar dhe ka në funksionim një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke filluar nga faqja zyrtare, sekretaria mësimore, strukturat ndihmëse akademike, sistemi PITAGORA dhe aksesit në internet me platformat Google Classroom, Moodle. Këto struktura ndihmojnë studentët të marrin informacion për veprimtarinë mësimore gjatë frekuentimit të programit, regjistrimet në provime dhe rezultatet e vlerësimit, të dhëna për lëndët, mjetet didaktike dhe tekstet. ²²⁸
Konkluzione	<i>GVJ mendon se standardi përmbushet plotësisht, pasi institucioni ka një sistem efektiv të informimit të studentëve për tërë aspektet e programit të studimit Bachelor në “Arsimin Parashkollor.</i>

²²² Rregullore e sekretarisë mësimore (Ref.Evidenca Nr. 138)

²²³ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al>.

²²⁴ Udhezues I Karrierës. (Ref.Evidenca Nr.21)

²²⁵ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> . Rubrika studentët. Kariera dhe Alumni.

²²⁶ Java e orientimit për studentët FE, UAMD, 17 Tetor 2022. (Ref.Evidenca Nr.24)

²²⁷ Guida e studentit, UAMD, 2022-2023. (Ref.Evidenca Nr. 24)

²²⁸ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al>

	<i>Rekomandojmë që kjo zyrë të evidentojë me dokumentacion çdo aktivitet apo veprimtari që kryen. (kriteri 3)</i>		
	<i>Standardi permbushet plotesisht</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe verifikimit të dokumentacionit në Sekretarinë mësimore rezulton se FE disponon statistika vjetore të studentëve që rregjistrohen për herë të parë dhe atyre që diplomohen, ²²⁹ <i>Evidenca nr. 69 e paraqitur ne RVB nuk figuron në numrin e evidencave të derguara nga institucioni por në evidencën e paraqitur për numrin e studentëve të punësuar pas diplomimit Sektori i Karrierës dhe Alumni nuk figuron asnjë student i punësuar (Evidenca 26.1).²³⁰</i> Statistika vjetore për studentët e diplomuar mban dhe FE pasqyruara në raportet vjetore të analizës së veprimtarisë mësimore kërkimore të tij. ²³¹
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit pranë Sekretarisë mësimore dhe verifikimit të tij gjatë vizitës në institucion në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e diplomave, si dhe të sistemit PITAGORA rezulton se për programin bachelor ka statistika për të gjitha aspektet që lidhen me vazhdimësinë e studimeve të këtij programi. ²³² Në këto statistika jepet edhe numri i të larguarve, të transferuar apo edhe të çrregjistruar. Në analizën vjetore të Fakultetit evidentohen për cdo program numri i të regjistruarve cilësia në hyrje, si dhe numri i të diplomuarve dhe cilësia në dalje. ²³³

²²⁹ Vizita në sekretarinë mësimore. (Referuar regjistrin të përparimit të studentëve dhe regjistri i diplomimit)

²³⁰ Të dhënë të ALUMNI mbi punësimin e të studentëve të UAMD.(Ref. Evidenca _Nr.26.1).

²³¹ Raport vjetore të veprimtarisë mësimore e kërkimore të FE, .(Ref. Evidenca.Nr.111).

²³² Verifikime ne sekretarine mësimore të dokumentacionit.

²³³ Analize e punes mesimore shkencore te FE (ref.Evidenca. Nr.111)

<p>cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sipas raportit numri i studenteve ne tre vite eshte :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 2022-2023 është 45 studentë - Për vitin akademik 2021-2022 është 35 studentë - Për vitin akademik 2020-2021 është 28 studentë
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga verifikimi i detyrave dhe përgjegjësive si dhe aktivitetit të sektorëve të këtij institucioni si Sekretarisë mësimore dhe Njësisë të Sigurimit të Brëndëshëm të Cilësisë dhe Sektori i Karrierës dhe Alumni rezulton se këto njësi menaxhojnë të dhënat statistikore lidhur me programin e studimit, dhe i kanë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit. Arritjet akademike të studentëve janë të aksesueshme edhe nepërmjet programit Pitagora.²³⁴</p> <p><i>Ky kriter në RVB e programit është kriteri 4 dhe referimet e bëra të rregullores së FE neni 74. Pika 7 nuk përkojnë me kriterin.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësisë përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Nga dokumentacioni që disponon UAMD rezulton se ka të përcaktuar qartë në aktet dhe rregulloret e tij (Statuti neni 77 deri 81) kontrollin periodik nga tërë njësitë që menaxhojnë programin e studimit Bachelor në “Arsimin Parashkollor. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brëndëshëm të Cilësisë, Sektori mbi çështjet mësimore dhe NJSBC ushtrojnë kontrolle mbi njësitë përgjegjëse për standartet e cilësisë të brëndshme të institucionit, kurrikulave dhe mësimdhënies, marrin feedback nga studentët lidhur me realizimin e programit, bëjnë analizë të gjendjes dhe hartojnë një raport vjetor që i dërgohet Rektorit dhe më pas i dërgohet gjithë njësisë bazë që mbulojnë programe studimi të nivelit të dytë.²³⁵</p> <p>Në shkallë institucioni “Komisioni i përhershëm për sigurimin e brendëshëm të cilësisë” përcakton kriteret, instrumentet matës dhe mënyrat e publikimit të rezultateve.²³⁶</p> <p><i>Ky kriter nuk është në RVB.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të</p>	<p>Konfirmojme se njësia bazë që mbulon programin e studimit Bachelor në “Arsimin Parashkollor” Departamenti i Pedagogjisë ka një dokumentacion lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, që verifikohet në dokumentacionin e Sekretarisë mësimore ²³⁷</p>

²³⁴ Rregullore e UAMD-së neni 89; (Ref.Evidenca. Nr. 3)

²³⁵ Statuti I UAMD. Neni 77 deri 81 (Ref.Evidenca Nr.1)

²³⁶ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në UAMD <https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf>

²³⁷ Të dhëna nga Sekretaria mësimore gjatë vizitës.

përmirësimin të këtyre treguesve.				
Konkluzione	GVJ mendon se kriteri përmbushet kryesisht pasi institucioni ka të dhëna për studentët në kohën kur ato vazhdojnë studimet por nuk ka dhe të dhëna për studentët pas diplomimit. (Kriteri 3) për punësimin. Standardi V/4 në RVB e paraqitur ka mospërputhje në kritere dhe nuk korespondojnë evidencat e paraqitura. Standardi përmbushet kryesisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimin të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UAMD në zbatim të Statutit (neni 89;90.) dhe rregulloreve të studimit të fakulteteve përkatëse (FE neni 92) ka përfshirë studentët nepërmjet përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si në Senatin akademik, Njësinë për Sigurimin e Cilësisë, Këshillit studentor zgjedhur në 2016 si vetorganizim i studentëve, në GVB, dhe shoqata dhe forume studentorë. ^{238 239} Aktualisht janë 2 studentë antarë të Senatit, 1 student antar i Këshillit të Etikës, nga 1 anëtar në GVB, 1 antar në Bordin e Administrimit
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UAMD si institucion dhe FE si njësi përgjegjëse e programit të studimit rezultojnë se ka një përfshirje reale të studentëve në vendimmarrje dhe që përpiqen të japin kontribut në përmisimin e veprimtarinë e institucionit. Kështu në takimin me studentë u theksua se pyetsori që realizohet për të dhënë opinionin mbi mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, publikohet në faqen zyrtare dhe është i aksesueshëm nga të gjithë, ka ndikuar në përmisimin e performancës së pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi. ²⁴⁰

²³⁸ Rregullore e FE. (Ref. Evidenca Nr.3.1)

²³⁹ Statuti i UAMD. (Ref.Evidenca Nr.1)

²⁴⁰ Faqja zyrtare e UAMD-së <https://uamd.edu.al>. Rubrika Transparenca (Informacion dhe dokumenta).

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e njësive kryesore dhe njësive bazë rezultojnë se gjatë tërë vitit akademik nga sektorët përgjegjës ushtrohen kontrole mbi ecurinë e procesit mësimor në programet e studimit që mbulon ajo, me instrumenta që sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe pasqyrohen në raportin vjetor të njësive.²⁴¹</p> <p>Studentët japin mendime dhe sugjerime për programin e studimit në takime që organizohen, fokus grupe, pyetësorë etj,²⁴² por <i>Departamenti i Pedagogjisë nuk e ka të pasqyruar me evidencë marrjen në konsideratë të këtyrë mendimeve apo sugjerimeve.</i></p> <p><i>Rekomandojmë evidentimin e kontributit të studentëve në procesin e hartimit apo të ndryshimeve në strukturën apo përmbajtjen e programit mësimor.</i></p> <p><i>Ky kriter nuk përputhet me kriterin 3 të RVB</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësive/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Ng shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se Fakulteti i Edukimit ka sanksionuar në rregulloren e studimit (neni 66;67;68;69) barazine dhe ndershmërinë në vlerësim,si dhe të drejtën e ankimit, dhe të rishikimit të vlerësimit.²⁴³</p> <p><i>Në RVB ky është kriteri 5</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mendon se UAMD dhe FE ka garantuar përfshirjen studentëve në të gjitha organet vendimmarrëse, dhe ka marrë në konsideratë mendimet e tyre për përmirësimin e programeve të studimit që ajo ofron,por Departamenti i Pedagogjisë nuk ka ndonjë evidencë të plotë ku të pasqyrojë reflektime për kontributin e studentëve në procesin e hartimit apo të ndryshimeve në strukturën apo përmbajtjen e programit mësimor(kriteri 3)</i></p> <p><i>Formati i paraqitur në RVB nuk përputhet me formatin që është dërguar tek ne nga Ascal. Standardi përmbushet kryesisht</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

²⁴¹ Raport vjetor i Departamentit të Pedagogjisë (Ref.Evidenca Nr. 5.1)

²⁴² Raport i rezultateve anketimit të studentëve për (Ref. Evidenca Nr 14.)

²⁴³ Rregullore e Fakultetit të Edukimit. (Ref.Evidenca Nr.3.1)

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UAMD në dispozicion të studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" (si edhe rezulton nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikuar në vizitën e realizuar në institucion), njësi shërbimi dhe informimi të studentëve si: Sekretaria Mësimore Drejtoria e Administrimit të Shërbimeve Akademike, (sektori i Publikimit Alumni dhe Komunikimi dhe sektori I IT), Këshilli studentor, Sistemi PITAGORA etj. ^{244 245}
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Rezulton se UAMD ka një sistem informimi dhe këshillimi të studentëve për tërë veprimtarinë dhe punën mësimor e të studentëve, duke e sanksionuar me urdhër Rektorati mënyrën e funksionimit të sistemit të tutoriali dhe mentorimit. ²⁴⁶ Për ndjekjen dhe marrjen informacion për përparimin e studentëve rezulton se funksionon platforma Pitagora, ku studentët regjistrohen nga sektori i IT, aplikacioni Moodle dhe Google Classroom. ²⁴⁷
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione	Në takimin me përfaqësuesen e Zyrës së Këshillimit dhe të Karrierës rezulton se kjo zyrë realizon një bashkëveprim të mirë me studentët duke u ofruar atyre informacion mbi procesin mësimor, probleme që lidhen me praktikën mësimore, dhe në mënyrë të veçantë orientimin e tyre për tregun e punës, ²⁴⁸ Në takimin me studentë u tha se kjo zyrë ka vazhdimisht kontakte me to dhe se dy ose tre herë në vit ka aktivitete të programuara në grup, për informimin apo orientimin e tyre për aspekte të ndryshme ²⁴⁹

²⁴⁴ Rregullore e sekretarisë mësimore në Fakultetin e Edukimit, neni 5;6;7;8. (Ref.Evidenca _Nr.138)

²⁴⁵ Struktura organizative e UAMD. (Ref.Evidenca _Nr.7)

²⁴⁶ Mbi Organizimin e Tutorialit/Mentorimit në UAMD.(Ref. Evidenca _Nr. 24.1)

²⁴⁷ Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al/studentet/>

²⁴⁸ Shembull i orientimit të studentëve të vitit parë në UAMD. (Ref.Evidenca _Nr.24)

²⁴⁹ Faqe zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al/studentet/>

të tjera dhe orientimin në tregun e punës.									
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Drejtoria e Administrimit të Shërbimeve Akademike, (sektori i Publikimit Alumni dhe Komunikimi) ndjek studentët pas diplomimit duke vënë në përdorim një pyetësor online me studentët e diplomuar dhe merr të dhëna lidhur me punësimin e tyre pas mbarimit të programit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" ka krijuar një databazë , e cila është e aksesueshme për të gjitha njesitë e institucionit. ^{250 251}								
Konkluzione	<i>Rezulton se UAMD ka një sistem informimi dhe këshillimi të studentëve për tërë veprimtarinë dhe punën mësimor e të studentëve, duke e sanksionuar me urdhër Rektorati mënyrën e funksionimit të sistemit të tutoriali dhe mentorimit.²⁵².</i> <i>GVJ mendon se ky standart përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel	Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se institucioni UAMD ka një zyrë që merret me edukimin në vazhdim dhe ka të hartuar module

²⁵⁰ Pyetësori tip për gjurmimin e punësimit të studentëve të programeve bachelor, Departamenti i Pedagogji. (Ref. Evidenca_Nr.25.1).

²⁵¹ Të dhëna nga Alumni mbi punësimin e të diplomuarve, programet bachelor FE, 2021- 2022. (Ref. Evidenca_Nr.26.1)

²⁵² Mbi Organizimin e Tutorialit/Mentorimit në UAMD.(Ref. Evidenca_Nr. 24.1)

<p>institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>kualifikuese, ka hartuar një manual për përgatitjen dhe korigjimin e provimeve në Clean Score,²⁵³ ka një modul për trainim në fushën e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie,²⁵⁴ por nuk rezulton se ka një udhëzues për përdorimin e metodave inovative apo evidencë të realizimit të ndonjë trainimi. Jepen evidenca si 184,186, 16, të cilat nuk janë në listën e evidencave të dërguara.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga njësia kryesore si dhe vizita e bërë në institucion rezulton se Fakulteti i Edukimit në bashkëpunim me Departamentin e Pedagogjisë si përgjegjëse për këtë program studimi, ka në funksionim të vazhdueshëm mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor të programit. Në rregulloren e funksionimit të NJSBC janë të përcaktuara qartë detyrat për një vazhdimësi të monitorimit të procesit të mësimdhënies²⁵⁵, Departamenti dhe NJSBC përdor instrumente vlerësues si pyetsorë me studente, vlerësimi nga kolegë, dhe vetvlerësimin e performancës nga vetë pedagogu,^{256, 257}</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Pedagogjisë bazuar në rregulloret e studimit ka garantuar përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve. Përdorimi i instrumentave të tillë si pyetsorët me studentët nga NJSBC-së për vlerësimin e performancës së pedagogëve dy herë në vit para provimeve, është një mundësi e mirë për përmisimin e procesit të mësimdhënies.²⁵⁸</p> <p>Po kështu rezulton se ka një sistem për marrjen dhe menaxhimin e ankesave të studentëve e konfirmuar kjo edhe me raste nga takimi me studentë.²⁵⁹</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit si njësi përgjegjëse për programin e studimit jep të dhëna lidhur me sigurimin e cilësisë strukturave të tilla si Komisionit të sigurimit të cilësisë dhe NJSBC të cilët publikojnë në faqen zyrtare të institucionit vlerësimin nga studentët i mësimdhënies. Në këtë faqe është publikuar një pyetsor për mësimdhënien online (shkurt 2021) dhe një relacion i NJSBC lidhur me mësimdhënien virtuale. Departamenti në analizën vjetore të punës (viti akademik 2019-20 dhe 2021-22. te ngjashëm në formatin</p>

²⁵³ Manual i krijimit të provimit, vlerësimi me Clean Score). (Ref.Evidenca_Nr.96)

²⁵⁴ Modul Trainimi Platformat teknologjike në mësimdhënie (Ref.Evidenca Nr. 113)

²⁵⁵ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë (Ref.Evidenca_Nr.15)

²⁵⁶ Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët- Shembull i rezultateve të vlerësimit. (Evidenca_Nr.)

²⁵⁷ Formulari i vlerësimit të performancës së pedagogut nga eprori/kolegu - shembuj të plotësuar V.A. 2022-2023. (Ref.Evidenca_Nr.)

²⁵⁸ Formulari i vetvlerësimit për pedagogët . (Evidenca_Nr.71)

²⁵⁹ Faqja Zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al> (Rubrika Ankesa)

	e tyre) nuk permban rezultatet e vlerësimeve të bëra si nga studentët ashtu edhe nga kolegët. ^{260 261}								
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nuk ka evidenca të tjera që flasin për promovim të praktikave të mira apo formave të nxitjes së personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, përveçse analiza vjetore e punës së departamentit, <i>ndaj rekomandojmë se ky promovim duhet të ketë një spektër më të gjërë.</i> ²⁶²								
Konkluzione	<i>GVJ mendon se Fakulteti ndjek një politikë të garantimit dhe promovimit të cilësisë të mësimdhënies dhe të praktikave të mira, por duhet të punojë për një spektër më të gjërë në këtë aspekt (kriteri 5) si dhe për hartimin e udhëzuesve për metodat inovative në mësimdhënie (kriteri 1).Standardi permbushet kryesisht</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UAMD ka ngritur një strukturë të plotë për sigurimin e cilësisë në shkallë fakulteti dhe institucioni. Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Senati Akademik; Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë. Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakultetit; Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program. ²⁶³

²⁶⁰ Faqja Zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al> Rubrika Transparenca (Informacione dhe dokumenta)

²⁶¹ Raport vjetor I Departamentit te Pedagogjisë. (Ref.Evidenca Nr. 5.1)

²⁶² Analiza vjetore e Departamentit tw Pedagogjisw viti akademik 2021-22 (Ref. Evidenca Nr.5.1)

²⁶³ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, (Ref. Evidenca Nr.16)

	Këto struktura punojnë mbi bazën e Planit strategjik të zhvillimit (2020-2025), rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brëndëshëm të sigurimit të cilësisë. ²⁶⁴
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga verifikimi gjatë vizitës në UAMD rezulton se në institucion ka një sistem të brëndëshëm për sigurimin e cilësisë i cili vepron bazuar në legjislacionin dhe rregulloren e miratuar për veprimtarinë e saj si njësi, dhe ka një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se duhet të jetë më efektive dhe e vazhdueshme puna e këtij sistemi. ²⁶⁵ Studentët kanë përfaqësimin e tyre në këto njësi, por <i>nuk rezulton se ka një ekspert të jashtëm i cili do të ndihmonte në rishikimin apo dhënie sugjerimesh lidhur me përmirësimin e punës.</i> ²⁶⁶
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UAMD përdor si vlerësimin e brëndëshëm ashtu edhe të jashtëm si dhe ka përcaktuar në rregulloren e brëndëshme të sigurimit të cilësisë edhe instrumentet përkatës për realizimin e vetvlerësimit si të institucionit ashtu edhe të programeve të studimit. Konfirmohet se UAMD i është nënshtruar 2 herë edhe vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional dhe me vendimin e fundit të BA Nr 18. Date 24/03/2022 ka marrë vlerësim pozitiv 4 vite 2022-2026 ,dhe është në proces akreditimi të programeve të studimit që ofron.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga takimet e organizuara në institucion për grumbullimin e të dhënave për analizat vjetore të veprimtarisë në shkallë njësie bazë, njësisë kryesore dhe si institucion në tërësi bazohet në instrumenta të qartë e të matshëm (si kontrollet e realizuara për mësimdhënien, pyetsorët me studentë, vlerësimi nga kolegët etj) Komisioni i perhershëm për sigurimin e cilësisë përcakton qartë instrumentat që përdoren në përputhje me natyrën e programeve dhe objektivave që ky komision ka. ^{267 268}

²⁶⁴ Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD, 2020-2025) (Ref. Evidenca_Nr.3)

²⁶⁵ Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD, 2020-2025) (Ref. Evidenca_Nr.2)

²⁶⁶ Faqja zyrtare UAMD. <https://uamd.edu.al> Rubrika Sherbime (NjSBC perberja)

²⁶⁷ Rregullore e UAMD. (Ref. Evidenca_Nr.3)

²⁶⁸ Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik. (Ref. Evidenca_Nr.71)

Konkluzione	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UAMD përdor si vlerësimin e brëndëshëm ashtu edhe të jashtëm si dhe ka përcaktuar në rregulloren e brëndëshme të sigurimit të cilësisë edhe instrumentët përkatës për realizimin e vetvlerësimit si të institucionit ashtu edhe të programeve të studimit.</i></p> <p><i>GVJ mendon se institucioni ka ndërtuar një strukturë të plotë dhe ka hartuar rregullore studimit për të ndjekur sigurimin e cilësisë, por nuk ka ekspertë të jashtëm si pjesë e kësaj strukture (kriteri2)</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe i verifikuar gjatë vizitës në institucion mund të konkludojmë se institucioni përdor mekanizma të ndryshëm formalë për të realizuar mbikëqyrjen e programit të studimit Bachelor në “Arsimin Parashkollor” në shërbim të akreditimit, në përputhje me planin strategjik dhe rregulloren e institucionit për sigurimin e cilësisë. Në këtë rregullore (neni 6; 8; 10 11) përcaktohen qartë detyrat e NJSBC dhe strukturave të tjera për përgatitjen periodike të raporteve të vlerësimit të cilësisë.²⁶⁹</p> <p>Rezulton se në vitin akademik 2018-2019 ka një përmisim të kurrikulës duke iu përshtatur Ligjit të ri të Arsimit Lartë.</p> <p>Departamenti I Pedagogjisë në raportin vjetor të punës evidenton disa përparësitë dhe mangësitë por nuk rezulton se ka nje plan masash për tu zbatuar nga njësia bazë lidhur me programin e studimit Bachelor Arsim Parashkollor.²⁷⁰</p>

²⁶⁹ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, (Ref. Evidenca Nr.16)

²⁷⁰ Raport vjetor I Departamentit te Pedagogjisë. (Ref.Evidenca Nr. 5.1)

<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga verifikimi I raporteve vjetore të punës mësimore dhe shkencore të departamentit rezulton se bazuar në rezultatet e vlerësimit të përfituara nga pyetorët me studentë, vlerësimin e kolegëve dhe vetvlerësimin të pedagogëve, verifikohen rezultatet e pritshme, bëhet edhe evidentimi I praktikave dhe arritjeve më të mira, si dhe përcaktohen mangësitë dhe kërcënimet lidhur me programet e studimit, por mendojmë se duhet të ketë edhe afate kohore për përmirësimin e mangësive.²⁷¹</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim I cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime 64dmini apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi I shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga vizita në institucion konfirmojmë që UAMD në kuadër të vlerësimit të realizimit e ecurisë së programit të studimit, aplikon metodologji vlerësimi të drejtëpërdrejta (të cilat janë përcaktuar në rregulloren e funksionimit dhe të sigurimit të cilësisë neni 5; 6; 9), për të bërë vlerësimin lidhur me realizimin e programit të studimit. Instrumentat më të aplikuar janë : vlerësimi I kurseve përbërëse të kurrikulës; vlerësimet 64dmini nga studentët të mësimdhënies, formati I vlerësimit nga kolegët të stafit akademik,formati I vetvlerësimit, veshgime për vlerësimin e praktikës profesionale, dhe të dhëna nga Alumni për studentët e diplomuar ^{272 273 274}</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e</p>	<p>Nga shqyrtimi I dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion konfirmojmë që UAMD UAMD në kuadër të vlerësimit të realizimit e ecurisë së programit të studimit aplikon metodologji vlerësimi të tërthorta (të cilat janë përcaktuar në rregulloren e funksionimit dhe të sigurimit të cilësisë), për të bërë vlerësimin</p>

²⁷¹ Raport vjetor I Departamentit te Pedagogjisë. (Ref.Evidenca Nr. 5.1)

²⁷² Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët- Shembull i rezultateve të vlerësimit.(Ref. Evidenca Nr.70)

²⁷³ Model pyetësi për studentët e diplomuar, Alumni). <https://uamd.edu.al/karriera/>. (Ref.Evidenca Nr.25.1)

²⁷⁴ Formular i vetvlerësimit të pedagogut.(Ref. Evidenca Nr.71)

<p>instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e 65 administrative, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>lidhur me realizimin e programit të studimit. Instrumentat më të aplikuar janë : sondazhe dhe mbledhje informacioni nga studentë të diplomuar nga Alumni, lidhur me përfitimet e tyre pas diplomimit, shkëmbim informacioni me institucionet bashkëpunuese etj^{275 276}</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion konfirmojmë që UAMD në kuadër të vlerësimin të realizimit e ecurisë së programit të studimit, aplikon metodologji vlerësimi të drejtëpërdrejta.</i></p> <p><i>GVJ mendon se standardi përmbushet plotësisht pasi institucioni nepërmjet njërive përgjegjëse të programit monitoron përpjekjet që bëhen për realizimin e objektivave të programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin</p>	<p>UAMD dhe Fakulteti i Edukimit në procesin e sigurimit të cilësisë rezulton se ka ndërtuar një sistem bashkëveprimi mes aktorëve të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm që marrin pjesë në këtë proces. Kjo realizohet nepërmjet pjesëmarrjes të studentëve në aplikimin e procesurave dhe komisioneve të vlerësimin të cilësisë, bashkëpunimin me studentët e diplomuar nepërmjet Alumnit,</p>

²⁷⁵ Shoqata e Karrierës dhe Alumnit në UAMD, Aktivitetet (Ref. Evidenca Nr.22)

²⁷⁶ Raport i anketimit të studentëve, stafit akademik, administrates per institucionin (Ref.Evidenca Nr14.)




dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Komisionit të përhershëm për garantimin e sigurimit të cilësisë, NJSBC etj. ^{277 278 279} <i>Por sic e kemi theksuar edhe me sipër nuk ka ndonjë ekspert të jashtëm të përfshirë në këtë proces</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rezulton se në Statutin e UAMD-së si dhe në Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, neni 2, janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë e tërë aktorëve që marrin pjesë në procesin e vlerësimit të cilësisë në institucion. Këto detyra dhe përgjegjësi janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të UAMD-së ^{280 281}
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Nga analiza e dokumentacionit dhe shqyrtimi i veprimtarive që organizon UAMD mund të konkludojmë se në procesin e sigurimit të cilësisë të programit të studimit Bachelor në “Arsimin Parashkollor” institucioni ngarkon me përgjegjësi njësinë kryesore dhe bazë, koordinatorin e programit si dhe të gjitha strukturat ndihmëse të saj. ^{282 283}
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe verifikimit gjatë vizitës në UAMD, konstatohet se sanksionuar në aktet rregullatore dhe Kodin e Etikes të institucionit, në procesin e përfshirjes dhe aktivizimit të stafit akademik dhe studentëve në procesin e vlerësimit, respektohen standartet dhe integriteti akademik i stafit, përsosmëria dhe liria akademike, respekti i ndërsjellë dhe dinjiteti njerëzor, shumëllojshmëria e mendimeve, kulturave gjinore dhe etnike përgjegjësia personale e institucionale si dhe llogaridhënia duke

²⁷⁷ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, (Ref. Evidenca_Nr.16)

²⁷⁸ Përfshirja e studentëve në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit). (Ref.Evidenca_Nr.17).

²⁷⁹ Vendim Nr. 57, Dt. 25.05.2020 I Senatit “Miratim i anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë”, UAMD). . Faqja zyrtare https://uamd.edu.al.vendime_Senati

²⁸⁰ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. (Ref. Evidenca_Nr.13)

²⁸¹ Faqja zyrtare e UAMD . <https://uamd.edu.al>. (Sherbime NJSBC)

²⁸² Statuti I UAMD.

²⁸³ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. (Ref. Evidenca_Nr.13)

	siguruar një trajtim të barabartë të pedagogëve, studentëve dhe vartësve. ²⁸⁴			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga verifikimi i evidencave të paraqitura gjatë vizitës në institucion rezulton se UAMD ka bërë pjesë aktive të procesit të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë të programit Bachelor në “Arsimin Parashkollor” gjithë bashkëpunëtorët e përfshirë në realizimin e këtij programi studimi, nepërmjet bashkëveprimit me studentë të diplomuar, institucionet bashkëvepruese për të marrë ekspertizë lidhur me ecurinë e programit. ^{285 286} Vlerësimet mendimet e tyre merren në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të programit.			
Konkluzione	<p><i>Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe verifikimit gjatë vizitës në UAMD, konstatohet se sanksionuar në aktet rregullatore dhe Kodin e Etikës të institucionit, në procesin e përfshirjes dhe aktivizimit të stafit akademik dhe studentëve në procesin e vlerësimit, respektohen standartet dhe integriteti akademik i stafit.</i></p> <p><i>GVJ mendon se standardi përmbushet plotësisht pasi rezulton se institucioni ka përfshirë të gjithë strukturat dhe institucionet bashkëpunuese për realizimin e programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe	Organizimi dhe menaxhimi institucional në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë, promovimi i një kulture të vëmëndjes ndaj cilësisë, është sanksionuar në “ Planin strategjik 2020-2025 të

²⁸⁴ Kodi i Etikës në UAMD neni 2,6; 14;16. (Ref. Evidenca Nr.4.)

²⁸⁵ Marreveshje bashkëpunimi të UAMD (Ref. Evidenca Nr.53)

²⁸⁶ Marreveshje bashkëpunimi me ZVA Durrës. (Ref.Evidenca Nr. 67)

bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UAMD-së (faqe 10-11) dhe në programin e transparencës, publikuar në faqen zyrtare të tij. ^{287 288} Nga vizita në institucion rezulton se administrata pranë fakulteteve ofron shërbime për studentë dhe të interesuarit sipas nevojave të tyre lidhur me programin e studimit dhe me aspekte që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe nga vizita në UAMD rezulton se institucioni ka të sanksionuar në Rregulloren e funksionimit dhe organizimit të sistemit të siguriit të cilësisë dhe në Planin strategjik detyrimin e publikimit të gjithë të dhënave dhe rezultateve në kuadër të vlerësimit të programeve të studimit që ajo ofron, dhe janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit. ²⁸⁹
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga shqyrtimi i Analizës vjetore të FE apo të Departamentit të Pedagogjisë rezulton se procesi i vlerësimit të programeve të studimit pas relacioneve të dhëna lidhur me rezultatet e vlerësimit, ka objektiva dhe prioritete por nuk shoqërohet me një plan masash me orientim përmirësimin e mangësive kur janë të konstatuara. ²⁹⁰ <i>Rekomandojmë hartimin e një plan veprimi masash për programin e studimit ku të përcaktohen qartë mangësitë dhe dobësitë e konstatuara dhe të hartohet një plan masash me afate kohore për realizimin e tyre.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i rregulloreve që disponon UAMD dhe Fakulteti i Edukimit, dhe veprimtarive të planifikuara dhe të realizuara nga kjo njësi, konstatohet se është siguruar ndikimi i këtyre veprimtarive për përmirësimin dhe rritjen cilësore të performancës së pedagogëve dhe studentëve dhe përmirësimin cilësor të programit të studimit. ^{291 292}
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe	Në vizitën në institucion GVJ u njoh me një praktikë të re të institucionit lidhur me veprimtaritë e organizuara për informimin dhe ndërgjegjësimin e tërë aktorëve pjesëmarrës në veprimtarinë mësimore për përmirësimin e cilësisë në programet e studimit. Si një

²⁸⁷ Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD, 2020-2025 (Ref.Evidenca_Nr.2)

<https://uamd.edu.al/epcontent/uploads/2023/02/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf>

²⁸⁸ Programi i transparencës së UAMD. <https://uamd.edu.al/programi-i-transparences/>

²⁸⁹ Faqe zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al/programi-i-transparences/>

²⁹⁰ Raport vjetor I Departamentit të Pedagogjisë (Ref.Evidences Nr.5.1)

²⁹¹ Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022. (Ref.Evidenca_Nr.82)

²⁹² Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al>

ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	risi e viteve të fundit ishte llogaridhënia e stafeve drejtuese para asamblesë akademike dhe studentëve për drejtimin dhe sigurimin e cilësinë në tërë programet e studimit.			
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion rezulton se administrata pranë fakulteteve ofron shërbime për studentë dhe të intersuarit sipas nevojave të tyre lidhur me programin e studimit dhe me aspekte që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë.</i> <i>GVJ mendon se standardi përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Arsim Parashkollor” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “UAMD”

Pika të forta

1. Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor ka një përvojë 10-vjeçare që zbatohet dhe ai tashmë është konsoliduar në formimin e mësuesve të arsimit parashkollor.
2. Programi i studimit mbulohet nga një staf akademik i kualifikuar për zbatimin e tij.
3. Kurrikula e programit përditësohet në përshtatje me ndryshimet kurrikulare në arsimin parashkollor konform Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parashkollor
4. Staf i akademik i programit është i përfshirë në projekte dhe veprimtari shkencore dhe në mësimdhënie në universitetet e vendeve të rajonit dhe më gjerë.
5. Njësia bazë zbaton marrëveshje institucionale me institucione rajonale dhe lokale të qeverisjes arsimore dhe bashkinë për zhvillimin e praktikave të studentëve.
6. Ky program studimi demonstroi qëndrueshmëri të numrit të studentëve në raport me programet homologe në institucionet e tjera.

Pika të dobëta

1. Nevoja për të patur një Udhëzues institucional lidhur me Metodologjitë e mësimdhënies dhe të të nxëniet të të rriturve.
2. Nevoja për të krijuar një klimë profesionale lidhur me proceset e vetëvlerësimit për efekt akreditimit të programeve të studimit në Departamentin e Pedagogjisë.
3. Mungesa në njësitet e sigurimit të brëndshëm të cilësisë në të gjitha nivelet e një eksperti të jashtëm i cili do të ndihmonte në rishikimin apo dhënie sugjerimesh lidhur me përmirësimin e punës.

Rekomandime

1. Të zëvendësohet lënda “Menaxhim klase” me një lëndë tjetër që lidhet ngushtë me menaxhimin e mjediseve të të nxëniet dhe të grupeve të fëmijëve të arsimit parashkollor.
2. Pas akreditimit, të rishihet plani mësimor nën frymën e sugjerimeve të grupeve të punës së MAS për përafrimin e kurrikulës së studimeve bachelor në mësuesi në arsimin parashkollor.
3. Të hartohet një udhëzuesi institucional për metodologjitë e mësimdhënies dhe të të nxëniet me të rriturit.
4. Të trajnohet në vijimësi stafi i Departamentit të Pedagogjisë lidhur me procedurat, hartimin e raportit dhe evidencat që i shërbejnë akreditimit të programeve të studimit.
5. Rekomandojmë që fakulteti që mbulon këtë program studimi të krijojë/përshtasin mjedise mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit si për edukim figurativ, punë dore ashtu edhe për teatrin me kukulla.
6. Rekomandojmë që Departamenti i Pedagogjisë të evidentojë dhe vlerësojë çdo veprimtari që kryen në lidhje me këtë program studimi duke promovuar me një spektër më të gjërë përvorjat pozitive dhe kontributin e studentëve në procesin e hartimit apo të ndryshimeve në strukturën apo përmbajtjen e programit mësimor.
7. Rekomandojmë që mangësitë dhe dobësitë e konstatuara gjatë kontrolleve dhe analizave të bëra nga Departamenti në lidhje me ecurinë e programit të shoqërohen me një plan veprimi me afate kohore për përmirësimin e tyre.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Arsim Parashkollor" provided by the Higher Education Institution "UAMD"

Strengths and affirmations

1. The Study program of Bachelor of Preschool Education has a 10-year experience of being implemented and it has already been consolidated in the training of preschool teachers.
2. The study program is covered by an academic, qualified staff for its implementation.
3. The curriculum of the program is updated in accordance with the Curriculum Framework of Preschool Education
4. The academic staff of the program is involved in scientific projects and activities and in teaching in the universities of the countries of the region and beyond.
5. The basic unit implements institutional agreements with regional and local institutions of educational governance and the municipality for the development of student internships.
6. This study program demonstrates stability of the number of students in relation to the homologous programs in other institutions

Weaknesses

1. The need to have an institutional Guide regarding the Adults Teaching and Learning Methodologies.
2. The need to create a professional climate related to self-evaluation processes for the effect of accreditation of study programs in the Department of Pedagogy.
3. Absence in the internal quality assurance units at all levels of an external expert who would help in the review or giving suggestions regarding the improvement of the work.

Recommendations

1. To replace the subject "Classroom Management" with another subject that is closely related to the management of learning environments and groups of preschool children.
2. After accreditation, have to revise the curriculum of program under the spirit of the suggestions of the working groups of MAS for the alignment of the curriculum of bachelor's studies in preschool education.
3. To draw up an institutional guide for adults teaching and learning methodologies.
4. To continuously train the staff of the Department of Pedagogy regarding the procedures, the drafting of the report and the evidences that serve the accreditation of the study programs.
5. We recommend that the faculty covering this study program create/adapt learning environments in accordance with the specific nature of the program for both visual education, handicrafts and puppets theater.
6. We recommend that the Department of Pedagogy records and evaluates every activity it carries out in relation to this study program, promoting with a wider spectrum the positive experiences and the contribution of students in the process of drafting or changes in the structure or content of the educational program.
7. We recommend that the deficiencies and weaknesses founds during the checks and analyzes made by the Department regarding the progress of the program be accompanied by an action plan with time limits for their improvement.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X